



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Performancës

SIGURIA E NXËNËSVE NË SHKOLLAT PUBLIKE NË KOSOVË

Prishtinë, gusht 2026

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji¹ i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000²).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë³, efikasitetit⁴ dhe efektivitetit⁵ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen raportit të auditimit të performancës "Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë", në konsultim me Drejtorin e Departamentit të Auditimit të Performances, Ariana Gjonbalaj Shala, e cila e ka mbikëqyrur dhe menaxhuar auditimin. Ekipi që realizoi këtë raport:

Mimozë Selimi, Udhëheqëse ekipi
Neki Krasniqi, Anëtar ekipi

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria,
Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011 <http://zka-rks.org>

¹ Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

² Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

³ Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm

⁴ Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

⁵ Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1.Hyrje	8
2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit	10
3 Gjetjet e auditimit	11
3.1 Rrjeti për menaxhimin e rasteve të dhunës nuk ka bashkëpunuar në formë efektive.....	12
3.2 Shkollat nuk kanë zbatuar mjaftueshëm masat për parandalimin e dhunës	14
3.3 Rastet e dhunës në shkolla nuk janë trajtuar në mënyrë efektive	22
3.4. Të dhënat e raportuara nga shkollat nuk janë të sakta dhe të besueshme	25
3.5 Policia nuk ka standardizuar procesin e raporteve kthyesë për shkollat.....	31
3.6 Qendrat për punë sociale nuk sigurojnë trajtim të vazhdueshëm dhe përgjigje të rregullt për rastet e referuara nga shkollat.....	33
3.7 Drejtoritë komunale të arsimit nuk kanë qenë efektiv në vendosjen e mekanizmave dhe rolin e tyre monitorues dhe mbikëqyrës.....	35
3.8 Mungesa e masave efektive të sigurisë fizike në shkolla	38
3.9 Politikat e MASHTI-it nuk janë mjaftueshëm efektive për sigurinë në shkolla .	43
3.10 Inspektorati i Arsimit nuk bën mbikëqyrjen e sigurisë në shkolla.....	45
4. Konkluzionet	47
5. Rekomandimet	49
Shtojca 1. Motivi i auditimit, kriteret, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .	51
Shtojca 2. Numri i rasteve sipas raporteve të Policisë dhe SMIA	59
Shtojca 3. Praktikat e shkollave private të vizituara	62
Shtojca 4. Letër konfirmimet dhe komentet e entiteteve.....	64

Lista e shkurtesave

ShFMU	Shkollë fillore e mesme e ulët
ShML	Shkollë e mesme e lartë
IAAP	Institucioni Arsimor për Arsimin parauniversitar
KDSH	Këshilli drejtues i shkollës
KN	Këshilli i nxënësve
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit
QPS	Qendra për Punë Sociale
PK	Policia e Kosovës
SMIA	Sistemi për menaxhimin e informacioneve të arsimit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Siguria dhe mirëqenia e fëmijëve në Kosovë janë të drejta themelore të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila përcakton që fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre. Kushtetuta kërkon që çdo veprim që ndikon tek fëmijët qoftë nga institucionet publike apo ato private të bëhet duke pasur parasysh interesin më të mirë të tyre.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës me temën “Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë”. Qëllimi i këtij auditimi ishte të vlerësohet nëse institucionet përgjegjëse kanë vendosur dhe zbatojnë mekanizma efektivë për parandalimin, trajtimin, raportimin dhe monitorimin e incidenteve të dhunës në shkolla. Gjithashtu është vlerësuar nëse këto mekanizma kontribuojnë në krijimin e një ambienti të sigurt për nxënësit. Fushëveprimi i këtij auditimi ka përfshirë periudhën 2022-2025, pjesë e auditimit ishin drejtoritë komunale të arsimit në tri komuna: Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, si dhe Drejtoria për Mirëqenie Sociale në komunën e Prishtinës. Ndërsa në nivel qendror janë: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit si dhe Policia e Kosovës.

Institucionet përgjegjëse kanë vendosur disa mekanizma dhe kanë ndërmarrë iniciativa për sigurinë në shkolla, megjithatë këto nuk funksionojnë si një sistem i koordinuar, i standardizuar dhe efektiv për parandalimin, trajtimin, raportimin dhe monitorimin e dhunës.

Shkollat kryesisht reagojnë pas incidenteve, ndërsa masat parandaluese, trajtimi i rasteve dhe raportimi në “Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim” nuk zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme.

Mungesa e të dhënave të sakta dhe analizave të mirëfillta ka kufizuar Ministrinë e Arsimit, Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe Inspektoratit të Arsimit për të vlerësuar gjendjen reale të sigurisë dhe për të ndërmarrë masa të bazuara në rrezik.

Si rezultat, nxënësit nuk përfitojnë gjithmonë mbrojtje, trajtim dhe mbështetje të duhur institucionale, ndërsa sistemi arsimor nuk ka siguri të mjaftueshme se rastet e dhunës dhe bullizmit parandalohen, trajtohen dhe përcillen deri në zgjidhje.

Gjatë zhvillimit të auditimit, disa nga institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë veprime për adresimin e mangësive të identifikuara.

Policia e Kosovës ka ndërmarrë iniciativë për përmirësimin e formularëve që përdoren për komunikimin me shkollat dhe evidentimin e rasteve.

Komuna e Ferizaj, në qershor 2026, ka instaluar kamera të sigurisë në njërin nga gjimnazet që nuk posedonte kamera.

Po ashtu, në komunën e Prishtinës, tetë shkolla kanë filluar për herë të parë raportimin e rasteve të dhunës në “Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim”, duke raportuar gjithsej 27 raste gjatë periudhës janar–prill 2026. Në komunën e Gjakovës, tri shkolla gjithashtu kanë filluar për herë të parë raportimin e rasteve në “Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim”. Këto veprime paraqesin hapa pozitivë, por, për shkak të shtrirjes së tyre të kufizuar, nuk i adresojnë në tërësi mangësitë sistemore të identifikuara gjatë auditimit.

Shkollat nuk sigurojnë zbatimin e vazhdueshëm të mekanizmave të paraparë për parandalimin e dhunës. Shkollat nuk kanë realizuar çdo herë kontrolle sistematike tek nxënësit në mënyrë që të shmangin bartjen e mjeteve të dëmshme dhe substancave të rrezikshme. Përderisa, aktivitetet apo ligjëratat sensibilizuese organizohen shumë rrallë dhe nuk janë gjithëpërfshirëse. Nuk ka plane veprimi për sigurinë në shkolla e as analizë të faktorëve të rrezikut të shkollës. Nuk ka kontrolle të qarta të hyrje-daljeve duke mos u siguruar se ndalohet qasja e personave të pa autorizuar në hapësirat shkollore. Kutia e ankesave edhe pse ishte vendosur në 12 shkollat e vizituara vetëm në tri prej tyre apo 25% e shkollave të vizituara kishin procedurë të hapjes ku kutia përdorej nga nxënësit.

Rastet e dhunës në shkolla nuk trajtohen në mënyrë efektive. Shkollat dokumentojnë kryesisht rastet më serioze të dhunës, ndërsa rastet tjera si bullizmi, përjashtimet nga grupet dhe format tjera të dhunës psikologjike e sociale nuk evidentohen çdo herë dhe nuk trajtohen në mënyrë të dokumentuar. Po ashtu, kishte raste serioze që nuk janë identifikuar nga vetë shkollat, por janë raportuar nga prindërit. Shkollat nuk kishin hartuar planet individuale të mbrojtjes dhe përkrahjes së nxënësve që janë viktimë të dhunës si dhe nuk kanë hartuar plane për mbështetjen të nxënësve me sjellje problematike. Trajtimi i rasteve mbetet kryesisht reagues dhe afatshkurtër.

Të dhënat e raportuara mbi rastet dhe incidentet e dhunës në shkolla nuk janë të sakta dhe të besueshme. Deri në dhjetor të vitit 2025, vetëm 2% e shkollave në gjithë Kosovën kanë raportuar rastet e dhunës dhe bullizmit në shkolla. Brenda një viti shkollor ishin raportuar gjithsej 45 raste në "Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim".

Në anën tjetër, në raportet e policisë së Kosovës ky numër sillet rreth 550 deri 600 raste të incidenteve të dhunës nga nxënësit në vit. Gjithashtu nga evidencat fizike të rasteve të dhunës që janë prezantuar nga 30 shkollat që ishin mostër auditimi janë identifikuar 535 raste të dhunës për periudhën 2022-2025. Kjo konfirmon se të dhënat e raportuara nga shkollat në sistemin "Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim" nuk paraqesin situatën reale të numrit të rasteve të dhunës në shkolla.

Qendrat për punë sociale në Prishtinë nuk arrijnë të ofrojnë shërbimet e kërkuara nga shkollat. Është identifikuar mungesë e evidentimit dhe regjistrimit të rasteve nga Qendrat për Punë Sociale, ndërsa të dhënat për referimet nga shkollat nuk përputhen me evidencat e këtyre qendrave. Po ashtu, në asnjërin nga tri qendrat nuk ishte caktuar zyrtar i specializuar për koordinimin e masave dhe ndërhyrjeve për mbrojtjen e fëmijëve. Përgjatë viteve 2022-2025 ishte mbajtur vetëm një tryezë multidisiplinare. Gjithashtu, nuk është respektuar afati prej 30 ditësh për kthimin e përgjigjeve ndaj shkollave lidhur me rastet e referuara, ndërsa ka raste kur shkollat nuk kanë pranuar fare përgjigje.

Drejtorja Komunale e Arsimit nuk ka kryer rolin e mbikëqyrjes dhe monitorimit. Komunat nuk kanë monitoruar shkollat lidhur me trajtimin dhe raportimin e rasteve të dhunës. Drejtoritë Komunale të Arsimit nuk kanë realizuar kontrolle për të vlerësuar nëse shkollat zbatojnë Protokollin për Parandalimin, Trajtimin dhe Referimin e Rasteve të Dhunës. Gjithashtu, mungojnë mekanizmat efektivë, masat mbështetëse, si dhe masat disiplinore apo edukative për menaxhimin e nxënësve me sjellje asociale. Ndërsa sa i përket infrastrukturës fizike në shkolla, nga 12 shkollat e vizituara, të gjitha kishin rrethoja dhe kamera sigurie. Megjithatë në 3 prej këtyre shkollave oborri i shkollës

përdorej si transit për kalimtarë dhe komunitetin duke e bërë edhe më të vështirë menaxhimin e sigurisë së nxënësve në hapësirat e shkollës. Kameran e sigurisë edhe pse ishin të instaluar në 12 shkollat, kemi vërejtur se nuk ishin të gjitha funksionale dhe mbulueshmëria me kamera është e ulët. Ndërsa në komunën e Ferizaj, shkolla me numrin më të lartë të rasteve të dhunës në raportet e policisë nuk posedonte kamera sigurie deri në qershor 2026.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka pasur zbrazëtira në aktet nënligjore si dhe nuk ka bërë inspektimin e sigurisë në shkolla. Kishte mungesë të harmonizimit mes akteve nën ligjore që rregullojnë trajtimin dhe raportimin e dhunës dhe dukurive tjera negative në shkolla. Kjo ka ndikuar që mos ti jepet prioriteti i duhur kësaj çështje as në nivel lokal. Për më tepër, inspektorati i arsimit asnjëherë nuk kishte bërë inspektim për sigurinë në shkolla, gjithashtu as ligji për inspektimin e arsimit nuk parasheh një inspektim të tillë. Gjithë kjo ka ndikuar që të mungojë llogaridhënia dhe mos të ketë siguri se shkollat trajtojnë gjitha rastet e dhunës dhe dukurive tjera negative.

Për të siguruar vendosjen dhe zbatimin e mekanizmave efektiv për parandalimin dhe trajtimin e dukurive negative në shkolla, ne kemi dhënë gjithsej 12 rekomandime. Lista e plotë e rekomandimeve është paraqitur në kapitullin pesë të këtij raporti.

Përgjigja e entiteteve të përfshira në auditim

Policia e Kosovës, Komuna e Ferizaj dhe Komuna e Gjakovës janë pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit dhe janë zotuar se do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna. Letër konfirmimin për pranimin e gjetjeve dhe rekomandimeve për këto tri entitete mund ta gjeni në shtojcën 4.

Ministria e Arsimit janë pajtuar pjesërisht me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit dhe janë zotuar se do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna. Letër konfirmimin dhe komentet e këtij entiteti mund ti gjeni në shtojcën 4.

Komuna e Prishtinës nuk kanë dërguar as Letër konfirmimin dhe as komente.

1.Hyrje

Të drejtat e fëmijëve sigurohen duke filluar nga familja e deri te institucionet arsimore dhe institucionet tjera publike të cilat drejtpërdrejt apo tërthorazi obligohen të garantojnë sigurinë dhe mirëqenien e tyre.


Rol thelbësor në garantimin e sigurisë së fëmijëve luajnë institucionet kryesore sikurse janë: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit, Drejtoritë Komunale të Arsimit, Inspektorati i Arsimit, Policia e Kosovës, Shkollat, Qendrat për punë Sociale etj.

Varësisht nga roli dhe kompetenca që kanë, këto institucione marrin masa dhe veprime me qëllim që të: identifikojnë, parandalojnë, trajtojnë dhe po ashtu raportojnë rastet e incidenteve të dhunës së nxënësve brenda dhe jashtë ambienteve të shkollave.

Pra, për mbrojtjen e interesit sa më të mirë të fëmijëve nevojitet qasje ndërinstitutionale dhe multidisiplinare.

Lidhur me çështjen e sigurisë në shkolla kontribut të lartë japin edhe stafi profesional mbështetës të cilët angazhohen në trajtimin e incidenteve në shkolla. Aktualisht në kuadër të arsimit parauniversitar në gjithë Kosovën duke përfshirë edhe paralelet e ndara fizike ekzistojnë gjithsej 970 shkolla publike⁶. Ndërsa janë të punësuar gjithsej 258 personel profesional mbështetës në nivel kombëtar⁷. Kjo nënkupton se numri i i personelit mbështetës është tre herë më i ulët se sa numri i shkollave publike në të gjitha nivelet e arsimit para universitar në Kosovë. Në diagramin⁸ në vijim kemi krahasuar numrin e shkollave publike të arsimit para universitar, me numrin e nxënësve dhe numrin e pedagogëve dhe psikologëve.

Diagram 1- Numri i shkollave publike në krahasim me numrin e personelit mbështetës deri në tetor 2025



Pra, nga diagrami shihet se personeli mbështetës është shumë i ulët në numër krahasuar me numrin e nxënësve por edhe me numrin e shkollave.

Baza ligjore për parandalimin dhe adresimin e dhunës në shkolla është Rregullorja 21/2013 për protokollin për parandalimin, trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar e cila është aprovuar nga Qeveria në vitin 2013.

⁶ Burimi: [Institucionet shkollore sipas niveleve, 2015/16-2023/24. SiteTitle](#) (Agjencia e Statistikave të Kosovës)

⁷ MASHTI, dt 09 Tetor 2025

⁸ Burimi: [Numri i nxënësve në arsimin fillor-mesëm të ulët, 2015/16-2023/24. SiteTitle](#), [Numri i nxënësve në arsimin fillor-mesëm të ulët, 2015/16-2023/24. SiteTitle](#), [Institucionet shkollore sipas niveleve, 2015/16-2023/24. SiteTitle](#) (Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Rregullorja parasheh që drejtorët e shkollave të evidentojnë rastet përmes regjistrave fizikë dhe të raportojnë në Drejtorinë Komunale të Arsimit dy herë në vit, të cilët pastaj përmbledhin të dhënat e gjitha shkollave dhe raportojnë në MASHTI.

Ndërsa në vitin 2015 është zhvilluar moduli i veçantë për raportim të rasteve të dhunës në sistemin "Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim" (Tutje: SMIA). Në anën tjetër, rregullorja e vitit 2013 nuk është përditësuar në linjë me zhvillimin e sistemit. Në vend të saj është hartuar një udhëzues për zbatimin e kësaj rregullore e cila tregon hapat e përdorimit të sistemit SMIA për raportim të rasteve të dhunës. Udhëzuesi i klasifikon llojet e dhunës sipas intensitetit duke i ndarë në tri shkallë si në vijim: shkalla 1- intensitet më i lehtë, shkalla 2-intensitet i mesëm i dhunës dhe shkalla 3-intensitet i lartë i dhunës duke treguar përfshirjen e akterëve në zgjidhjen e secilës nga shkallët.

Ndërsa shkollat private nuk e përdorin sistemin SMIA edhe pse operojnë me legjislacionin e njëjte dhe do duhej ta përdorin për raportim të rasteve njësoj si shkollat publike⁹.

Përmes këtij auditimi janë vlerësuar aktivitetet dhe veprimet e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për:

- Parandalimin,
- Trajtimin,
- Raportimin e incidenteve të dhunës në shkolla.

Gjatë auditimit janë analizuar dhe vlerësuar mekanizmat dhe veprimet e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse me qëllim që të garantojnë siguri fizike dhe psikologjike në shkollat publike në Kosovë.

⁹ MASHTI, email 02 dhjetor 2025, shkollat private nuk kanë qenë fushëveprim i këtij auditimi

2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Qëllimi i këtij auditimi ka qenë të vlerësohet nëse institucionet përgjegjëse kanë vendosur dhe zbatojnë mekanizma efektivë për parandalimin, trajtimin, raportimin dhe monitorimin e incidenteve të dhunës në shkolla. Gjithashtu është vlerësuar nëse këto mekanizma kontribuojnë në krijimin e një ambienti të sigurt për nxënësit.

Pyetjet kryesore të auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivës së auditimit janë parashtruar pyetjet kryesore të auditimit si në vijim:

1. A kanë krijuar institucionet përgjegjëse mekanizma efektiv për parandalimin dhe trajtimin e incidenteve në shkolla?
2. A janë efektive institucionet përgjegjëse në procesin e raportimit dhe monitorimit të incidenteve që ndodhin në shkolla publike?

Fushëveprimi i këtij auditimi ka përfshirë periudhën 2022-2025 me fokus në vlerësimin e mekanizmave ekzistues kundër dhunës në shkolla si dhe veprimeve të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për të garantuar sigurinë në shkolla.

Në fushëveprim të këtij auditimi janë përfshirë edhe drejtoritë komunale të arsimit në tri komuna: Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, si dhe Drejtoria për Mirëqenie Sociale në komunën e Prishtinës, përkatësisht qendrat për punë sociale. Ndërsa në dy komunat tjera nuk është përfshirë drejtoria e mirëqenies sociale, për shkak se shkollat që ishin mostër auditimi në këto komuna nuk kanë ofruar raste të referimit të nxënësve në qendrat për punë sociale.

Në nivel qendror fushëveprim i auditimit ka qenë: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit (MASHTI) përkatësisht Inspektorati i Arsimit dhe Departamenti i arsimit parauniversitar si dhe Policia e Kosovës, më saktësisht janë analizuar aktivitetet e Policisë së Kosovës në tri komunat e përfshira në auditim.

Subjekt i auditimit në nivel lokal ishin shkollat publike të arsimit të mesëm të ulët dhe shkollat publike të arsimit të mesëm të lartë në tri komunat e përfshira në fushëveprimin e auditimit.

Metodologjia e detajuar e aplikuar gjatë këtij auditimi, problemi i auditimit, kriteret e auditimit, fushëveprimi i auditimit, përshkrimi detaj i sistemit dhe përgjegjësitë e palëve relevante janë paraqitur në *Shtojçën 1* të këtij raporti.

3 Gjetjet e auditimit

Në këtë kapitull janë përfshirë gjetjet e auditimit lidhur me mekanizmat që institucionet kanë vendosur dhe zbatuar sa i përket parandalimit, trajtimit, raportimit dhe monitorimit të incidenteve të dhunës në shkolla. Gjithashtu kemi vlerësuar nëse mekanizmat e vendosur kontribuojnë në krijimin e një ambienti të sigurt për nxënësit.

Në kuadër të këtij auditimi janë përfshirë gjithsej 30 shkolla publike të arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në tri komunat e audituara: Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë.

Për këto shkolla janë analizuar mekanizmat që zbatojnë dhe qasja e tyre për parandalimin, zgjidhjen e rasteve të dhunës, dhe raportimit. Nga këto, janë vizituar gjithsej 12 shkolla, ku janë realizuar intervista dhe takime me menaxhmentin e shkollave si dhe me përfaqësues të këshillit drejtues apo këshillit të prindërve të shkollave përkatëse. Gjithashtu, janë vizituar dy shkolla private njëra me afër 200 nxënës dhe tjetra me rreth 1000 nxënës. Shkollat private nuk kanë qenë pjesë e fushëveprimit të auditimit, mirëpo vizitat në këto dy shkolla janë realizuar vetëm për qëllime krahasuese të praktikave të tyre lidhur me sigurinë e nxënësve karshi praktikave të shkollave publike.

Në Komunën e Prishtinës janë përfshirë 13 shkolla, prej të cilave janë vizituar 5 shkolla. Në Komunën e Ferizajt janë përfshirë 10 shkolla, prej të cilave janë vizituar 4 shkolla, ndërsa në Komunën e Gjakovës janë përfshirë 7 shkolla, prej të cilave janë vizituar 3 shkolla.

Përbërja e mostrës së auditimit sipas komunave dhe nivelit të shkollave është si në vijim:

Tabela 1- Mostrat e auditimit

Komuna	Shkolla në mostër	Shkolla të vizituara	ShFMU	ShML
Prishtinë	13	5	9	4
Ferizaj	10	4	6	4
Gjakovë	7	3	5	2
Gjithsej	30	12	20	10

Po ashtu, në kuadër të auditimit janë përdorur të dhënat dhe raportet e Policisë së Kosovës lidhur me incidentet dhe rastet e dhunës, si dhe janë realizuar pyetësorë me 771 nxënës nga komunat e përfshira në auditim. Në Prishtinë kanë marrë pjesë 462 nxënës, Ferizaj 197 nxënës dhe Gjakovë 112 nxënës.

Gjetjet në vijim janë të ndara në tri pjesë të përgjithshme:



1. Roli dhe përfshirja e akterëve në luftimin e dhunës dhe dukurive negative në shkolla



2. Parandalimi dhe trajtimi i dhunës dhe bullizimit në shkolla



3. Mbikqyrja, moniorimi dhe raportimi i dhunës në shkolla

3.1 Rrjeti për menaxhimin e rasteve të dhunës nuk ka bashkëpunuar në formë efektive

Protokolli për parandalim dhe trajtim përcakton detyrimet, rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin dhe raportimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit parauniversitar. Po ashtu, kërkohet forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe multidisiplinarpër mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna¹⁰.


Rastet e dhunës me bazë në shkolla fillojnë të trajtohen nga shkollat, por jo çdo herë zgjidhen prej tyre. Për mbrojtjen sa më të mirë të interesit të fëmijëve, është i domosdoshëm bashkëpunimi ndërinstitucional dhe multidisiplinar.

Rregullorja për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, e aprovuar në vitin 2013 (tutje: rregullorja për protokollin) është dokumenti kryesor që rregullon trajtimin e rasteve të dhunës me bazë në shkolla.

Po ashtu, ekziston udhëzuesi për zbatimin e rregullores i vitit 2015. Ndërsa, në vitin 2023 është aprovuar edhe Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve, me qëllim të mbështetjes dhe zbatimit të kësaj rregullore.

Përfshirja ndërinstitucionale dhe multidisiplinare në rastet e dhunës është paraqitur diagramin si më poshtë.

Diagrami 2-Rrjeti i institucioneve të përfshira në zgjidhjen e rasteve të dhunës¹¹.



¹⁰ Rregullorja QRK Nr. 21/2013, Neni 1

¹¹ Modeli i Grafikut inspiruar nga broshura/posteri i MASHTI

Megjithëse institucionet përgjegjëse përfshihen në trajtimin e rasteve të dhunës në shkolla, procesi aktual nuk është mjaftueshëm i qartë dhe efektiv. Rregullorja ekzistuese fokusohet kryesisht në rastet e dhunës që ndodhin brenda hapësirave të shkollës.

Ajo nuk e përcakton qartë se si duhet të trajtohen rastet e bullizmit në rrjete sociale apo konfliktet mes bashkëmoshatarëve që fillojnë në shkollë dhe vazhdojnë jashtë saj.

Për këtë arsye, shkollat kanë zhvilluar praktika të ndryshme. Disa shkolla raportojnë dhe trajtojnë edhe rastet që ndodhin jashtë shkollës, ndërsa disa të tjera trajtojnë vetëm rastet e dhunës dhe dukurive tjera negative që ndodhin brenda shkollës.

Gjithashtu, koordinimi ndërmjet institucioneve nuk është i mjaftueshëm. Në rastet kur shkollat referojnë rastet në Polici apo në Qendra për Punë Sociale, nuk ka gjithmonë raport kthyes dhe nuk sigurohet përcjellje e vazhdueshme e rastit deri në përfundim. Nuk janë të qarta linjat e raportimit, roli i menaxherit të rastit dhe përgjegjësitë e secilit institucion në procesin e trajtimit. Për më tepër, MASHTI nuk kishte hartuar formularët standard të referimit, edhe pse ata janë paraparë me rregulloren për protokollin.

Kjo gjendje ka ndodhur për shkak se MASHTI nuk ka siguruar zbatimin e plotë dhe të standardizuar të protokollit përmes inspektimit, nuk ka përditësuar dhe sqaruar mjaftueshëm procedurat për format (llojet) e reja të dhunës dhe nuk ka vendosur mekanizma efektivë të monitorimit për mënyrën se si shkollat dhe institucionet tjera i trajtojnë rastet.

Për pasojë, rastet trajtohen në mënyrë jo të njëtrajtshme dhe jo të plotë, shkollat nuk kanë procedurë standarde për trajtimin e rasteve. Për më tepër transferimi i përgjegjësisë nga njëri institucion tek tjetri, rrit rrezikun që rastet e dhunës dhe bullizmit të mos adresohen në mënyrë adekuate dhe efikase për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve nga gjitha format e dhunës.

3.2 Shkollat nuk kanë zbatuar mjaftueshëm masat për parandalimin e dhunës

Institucionet e arsimit parauniversitar kanë detyrë parandalimin e dhunës ndaj nxënësve duke rritur vetëdijen me programe të ndryshme kundër dhunës (aktivitete, ligjërata, debate). Të kontrollojnë nxënësit për të shmangur bartje të mjeteve të rrezikshme, të identifikojnë nxënësit me rrezik potencial për sjellje të dhunshme, të vendosin kutinë e ankesave dhe të hapet sipas rregullave të institucionit ¹².

Shkollat bëjnë përpjekje në forma të ndryshme për ruajtjen e disiplinës dhe shmangien e konflikteve mes nxënësve. Në vijim kemi listuar disa praktika të mira mbi parandalimin e dhunës që kemi identifikuar në disa nga 30 shkollat që ishin mostër e auditimit.

Tabela 2-Praktika të parandalimit të identifikuar në shkollat që ishin mostër auditimi

Shkolla	Aktivitet parandalues
Gjon Sereçi- Ferizaj; 7 Shtatori- Prishtinë	Video sensibilizuese kundër dhunës dhe bullizmit me nxënës të shkollës
Naim Frashëri- Ferizaj	Qasje proaktive e psikologes, ligjërata dhe seanca kundër dhunës dhe bullizmit
Tefik Çanga- Ferizaj	Këshilli i nxënësve (KN) është shumë aktiv dhe mbështet nga drejtori për aktivitete. Çështjet që kanë trajtuar KN janë: funksionalizimi i kutisë së ankesave, mungesat e mësimdhënësve si shkak për konfliktet e nxënësve, ndëshkimi i sjelljeve të këqija të nxënësve duke i angazhuar këta nxënës me punë shtesë.
Pavarësia-Prishtinë; Gjergj Fishta- Prishtinë Selman Riza- Gjakovë	Pyetësor me nxënës
Zekria Rexha- Gjakovë	Kontrolle të rregullta nëpër klasa, kujdestarët e ditës raportojnë secilin incident në raportet ditore, kontrolle për mbajtje të telefonit
Hajdar Dushi- Gjakovë	Mbledhja e telefonave në orën e parë në secilën klasë dhe vendosja e tyre në kuti plastike dhe ruhen në sallë të arsimtarëve deri në orën e fundit

Po ashtu, me qëllim të identifikimit të praktikave të mira kemi vizituar edhe dy shkolla private ku kemi identifikuar metodat e punës dhe praktikat që këto shkolla aplikojnë lidhur me parandalimin dhe trajtimin e incidenteve të dhunës në shkolla.

Në këto shkolla është identifikuar se në përgjithësi ka siguri më të lartë në aspektin e kontrollës së hyrje daljes në shkolla, dyert e oborrit mbahen të mbyllura dhe ka roje në hyrje, po ashtu është identifikuar procedurë me e standardizuar në qasjen e tyre ndaj dhunës në shkollë. Detajet e identifikuar nga vizita në këto dy shkolla private i gjeni në **Shtojca 3- Praktikë e shkollave private të vizituara**.

¹² Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, neni 9, pika 1.1 deri 1.10

Ndërsa gjatë analizimit të shkollave që ishin mostër auditimi është identifikuar se masat parandaluese për sigurinë në shkolla zbatohen në nivel të ulët. Këto masa janë: kutia e ankesave, kontrolle parandaluese ndaj nxënësve për të shmangur bartjen e mjeteve të rrezikshme dhe substancave të dëmshme, ligjëratat sensibilizuese me nxënës, planet e veprimit të sigurisë së shkollës dhe analizat e faktorëve të rrezikut në shkolla dhe mungesa e kontrolleve efektive të hyrje-daljeve në shkolla.

Në tabelën në vijim janë paraqitur numri i shkollave dhe përqindja e zbatimit të masave parandaluese për secilën nga komunat që ishin mostër e auditimit.

Tabela 3- Lloji i masave që zbatojnë shkollat për parandalimin e dhunës dhe bullizmit


Komuna	Prishtinë		Ferizaj		Gjakovë	
Numri i shkollave mostër	13		10		7	
Lloji i masave që janë zbatuar nga shkollat	Shkollat që kanë zbatuar masën	% sipas mostrave	Shkollat që kanë zbatuar masën	% sipas mostrave	Shkollat që kanë zbatuar masën	% sipas mostrave
Plani dhe zbatimi i kujdestarive në koridore	12	92%	4	40%	7	100%
Kontrollat të nxënësve (në klasa apo hyrje)	6	46%	3	30%	6	86%
Aktivitetet/Ligjëratat vetëdijësuese me nxënës	6	46%	4	40%	4	57%
Plani i veprimit të sigurisë në nivel shkolle	4	31%	2	20%	1	14%
Ekipe të veçanta për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës	1	8%	0	0%	1	14%

Edhe pse shkollat janë deklaruar se i zbatojnë këto aktivitete, në shumicën e rasteve nuk kanë arritur të sigurojnë dëshmi mbështetëse.

1. Kontrollimi i nxënësve. Sipas deklarimeve të shkollave, kontrollet e befasishme ndaj nxënësve realizohen sipas nevojës dhe pa planifikim paraprak, prandaj në shumicën e rasteve nuk dokumentohen me raporte apo procesverbale. Shkollat në Komunën e Gjakovës kanë treguar nivel më të lartë të realizimit dhe dokumentimit të këtyre aktiviteteve, duke ofruar edhe dëshmi të koordinimit ndërmjet stafit.

Gjatë auditimit është vërejtur se shkollat hezitojnë të realizojnë kontrolle të befasishme për shkak të shqetësimeve lidhur me ankesat e mundshme për cenim të privatësisë së nxënësve. Për pasojë, ekziston rreziku që shkollat të mos identifikojnë me kohë nxënësit që posedojnë mjete të rrezikshme, armë apo substanca të ndaluara.

Për të vlerësuar nëse masat ekzistuese krijojnë ndjenjë të mjaftueshme sigurie te nxënësit, në pyetësor ku kanë marr pjesë 771 nxënës, është përfshirë pyetja: **“A ke qenë dëshmitar i posedimit të armëve në shkollë?”**

Grafiku 1- Numri i nxënësve që kanë qenë dëshmitar të posedimit të armëve në shkollë

Sikurse shihet në grafik 21% e nxënësve në Prishtinë janë deklaruar se kanë qenë dëshmitar të posedimit të armëve në shkollë, 16% në Gjakovë dhe 8% në Ferizaj.

2. Aktivitet sensibilizuese (ligjërata, programe). Edhe në këtë aspekt, shkollat kanë deklaruar se zhvillojnë aktivitete dhe ligjërata vetëdijësuese, duke ofruar plane dhe tema të planifikuara, por nuk kanë ofruar dëshmi konkrete apo lista të pjesëmarrjes së nxënësve. Përgjithësisht bëjnë disa aktivitete të realizuara nga Policia e Kosovës, për të cilat janë ofruar dëshmi. Disa shkolla janë deklaruar se praktikojnë që në rast kur mungon ndonjë mësues dhe nxënësit janë të lirë, psikologu realizon aktivitetet me nxënës. Megjithatë kjo nuk është praktikë që garanton gjithë-përfshirje dhe vazhdueshmëri të aktiviteteve.

Sipas shkollave, organizimi i aktiviteteve vetëdijësuese paraqet sfidë, pasi që me qëllim që mos të humbasin orët mësimore ato duhet të realizohen jashtë orëve mësimore dhe nxënësit nuk qëndrojnë në shkollë pas përfundimit të mësimi.

Për pasojë, aktivitetet organizohen rrallë, kryesisht në data të shënuara ndërkombëtare dhe nuk janë gjithëpërfshirëse, pasi përfshijnë vetëm një numër të kufizuar nxënësish. Gjithashtu pyetësorët me nxënës kanë treguar se aktivitet sensibilizuese nuk zhvillohen në vazhdimësi nga shkollat.

Tabela 4- Përgjigjet e nxënësve lidhet me aktivitetet sensibilizuese për parandalimin e dhunës dhe dukurive tjera negative në shkolla


A organizohen në shkollë aktivitete për parandalimin e dhunës?	Ferizaj	Gjakovë	Prishtinë
Ndonjëherë	35%	48%	38%
Po, shpesh	23%	27%	34%
Rrallë	28%	18%	22%
Kurrë	15%	7%	7%

Pra nga tabela shihet se numri i nxënësve që janë deklaruar se në shkollën e tyre organizohen shpesh ligjërata dhe aktivitete sensibilizuese me nxënës është më i ulët se 35%.

3. Plani i veprimit të sigurisë në nivel shkollë. Vetëm një shkollë, Gjergj Fishta në Prishtinë, kishte hartuar plan të veprimit të sigurisë dhe nga viti 2023 kishte funksionalizuar ekipin për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve i cili parashihet me rregulloren për protokollin dhe me udhëzuesin për zbatim të kësaj rregullore. Ky ekip është paraparë si mekanizëm për ndërmjetësim jo formal mes bashkëmoshatarëve. Shkollat tjera kanë filluar hartimin e planeve të sigurisë dhe formimin e ekipeve vetëm pas shtatorit 2025, ndërsa shumica prej tyre nuk kishin përcaktuar personat përgjegjës për zbatimin e tyre.

Meqenëse planet e sigurisë dhe ekipet përkatëse kanë për qëllim parandalimin e incidenteve dhe krijimin e një ambienti më të sigurt për nxënësit, perceptimi i nxënësve është përdorur si tregues plotësues për të vlerësuar nëse shkollat po arrijnë të ofrojnë ndjenjë të mjaftueshme sigurie. Në tabelën më poshtë kemi paraqitur përgjigjet e nxënësve lidhur me pyetjen **“A është shkolla jote vend i sigurt për nxënësit?”**

Grafiku 2-A mendojnë nxënësit se shkolla e tyre është vend i sigurt



Sikurse shihet në grafik në përjashtim të komunës së Gjakovës, në dy komunat tjera rreth 50% e nxënësve, të cilët kanë marrë pjesë në pyetësor, janë përgjigjur se shohin shkollën e tyre si vend të sigurt.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së udhëzimeve dhe njohurive të nevojshme për hartimin e planeve të veprimit të sigurisë dhe organizimin e mekanizmave funksionalë për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës. Për pasojë, shumica e shkollave nuk kanë plan veprimi të sigurisë si dhe nuk kanë ekipe të specializuara dhe mekanizma efektivë për trajtimin dhe parandalimin e rasteve të dhunës dhe dukurive negative në shkolla.

4. Kutia e Ankesave. Nga 12 shkollat e vizituara gjatë auditimit, të gjitha kishin të vendosur fizikisht kutinë e ankesave, por vetëm tri prej tyre kishin procedura dhe dokumentim për funksionalizimin e saj. Në 75% të shkollave, kutia e ankesave kishte mbetur vetëm formalisht e vendosur dhe nuk funksiononte si mekanizëm praktik për raportimin e shqetësimeve nga nxënësit. Po ashtu, në disa raste kutitë ishin vendosur në hapësira të papërshtatshme ku nuk sigurohej anonimiteti i nxënësve gjatë raportimit. Ndërsa, disa shkolla nuk e kanë konsideruar të nevojshme këtë mekanizëm, duke u deklaruar se nxënësit ndiejnë liri që të raportojnë rastet direkt tek menaxhmenti apo mësimdhënësit e shkollës.

Kjo gjendje ka ndodhur për shkak të mungesës së rregulloreve dhe procedurave nga komunat dhe shkollat për menaxhimin e kutisë së ankesave.

Megjithatë, pyetësorët me nxënës kanë treguar se një pjesë e tyre hezitojnë të raportojnë rastet apo incidentet e dhunës, ku janë deklaruar se kanë frikë që raportimi nuk trajtohet me konfidencialitet apo nuk ndihen se rastet merren seriozisht nga shkolla. Në tabelën më poshtë janë paraqitur përgjigjet e nxënësve në lidhje me pyetjen: **“A ndjen liri të raportosh incidentin e dhunës”?**

Tabela 5- Sa ndiejnë nxënësit liri për të raportuar incidentet e dhunës

A ndjen liri të raportosh incidentin e dhunës?	Ferizaj	Gjakovë	Prishtinë
Po, gjithmonë	52%	67%	50%
Ndonjëherë	32%	23%	34%
Jo, kam frikë ose nuk besoj se do të merret seriozisht	10%	7%	12%
Jo, sepse raportimi nuk trajtohet me konfidencialitet	5%	3%	5%

Për më tepër sikurse shihet në tabelën më poshtë, një përqindje e nxënësve deri 12% janë deklaruar se nuk kanë informacion se ku duhet të raportojnë një rast dhune.

Tabela 6- A e dijnë nxënësit se kujt duhet t'i raportojnë

A e di kujt duhet ti raportosh një rast dhune?	Ferizaj	Gjakovë	Prishtinë
Drejtorit	33%	54%	42%
Mësuesit	37%	20%	24%
Psikologut	17%	13%	20%
Nuk e di	12%	8%	12%
Inspektoratit të arsimit	2%	4%	1%
Online	0%	1%	0%

Për pasojë, mungesa e funksionalizimit të kutisë së ankesave dhe e kanaleve alternative për raportim kufizon identifikimin e hershëm të rasteve të bullizmit dhe problemeve tjera me të cilat përballen nxënësit.

Mos zbatimi i masave parandaluese të lartpërmendura ka ndodhur për arsye se shkollat nuk janë monitoruar dhe kontrolluar asnjëherë në lidhje me zbatimin e masave parandaluese për sigurinë në shkolla qoftë nga DKA apo nga inspektorati i arsimit. Kjo ka ndikuar që qasja e shkollave të mbetet më shumë reaguese ndaj incidenteve se sa parandaluese.

Për pasojë shkollat nuk arrijnë të identifikojnë në mënyrë efektive nxënësit me rrezik potencial për posedim të armëve apo mjeteve tjera të rrezikshme, si dhe nuk kanë arritur të shmangin rrezikun e bartjes së mjeteve të rrezikshme brenda shkollës, ku në vitin 2022-2025 në tri komunat nga policia e Kosovës janë gjetur 133 nxënës në posedim të pa autorizuar të armës.

Në anën tjetër, sa i përket strukturave të shkollës të parapara me legjislacionin në fuqi, sikurse janë: këshilli drejtues, këshilli i prindërve, këshilli i nxënësve dhe komisioni disiplinor, gjendja është dukshëm më e mirë se sa ajo e masave parandaluese të lartpërmendura.

Në të gjitha komunat e audituara mbi 50% e shkollave i kishin themeluar këto struktura. Këshilli drejtues është aktiv në 92% të shkollave në Prishtinë, në 90% në Ferizaj dhe 86 % e shkollave në Gjakovë.

Kjo ndodhë për arsye se strukturat në fjalë: këshilli drejtues, këshilli i prindërve, këshilli i nxënësve dhe komisioni disiplinor kontrollohen gjatë inspektimeve administrative nga inspektorati i arsimit. Zbatimi i ulët i masave parandaluese, është reflektuar edhe në perceptimet dhe kërkesat e nxënësve.

Për të kuptuar se cilat masa i konsiderojnë nxënësit të nevojshme për përmirësimin e sigurisë, në pyetësor është përfshirë pyetja: **“Cilat veprime mendon se duhet të ndërmerren nga shkolla për të rritur sigurinë”?**

Përgjigjet më të shpeshta të nxënësve janë paraqitur në vijim:

Tabela 7- Komuna Prishtinë

Kërkesa/ Sugjerimi i nxënësve	Sami Frashëri	7 Shtatori	Ismail Qemali	Meto Bajraktari	Andon Çajupi
Kontrolla të rregullta të nxënësve në klasa, në hyrje dhe çantat	16%	10%	11%	3%	4%
Të ketë siguri/roje në shkollë		10%	6%	4%	12%
Të ketë më shumë kamera në shkollë, vëzhgim i kamerave	7%		10%	8%	12%
Më shumë përkrahje nga arsimtarët/të marrin rastet më seriozisht	11%	13%	10%	5%	
Masa më të rrepta disiplinore dhe përjashtim nga shkolla për nxënës problematik	11%	5%	8%	7%	7%
Aktivitetet vetëdijësuese kundër dhunës & bullizmit	10%		2%	9%	
Tualetet të jenë më të sigurta				2%	
Mos të lejohet dalja e nxënësve jashtë shkollës			3%		
Polic civil te shkolla					4%
Gjithsej 462 nxënës	89	39	159	100	75

Tabela 8- Komuna Ferizaj

Kërkesa/ Sugjerimi i nxënësve	Faik Konica	Kuvendi i Arbërit	Gjon Sereçi	Naim Frashëri
Kontrolla të rregullta të nxënësve në klasa, në hyrje dhe çantat	13%	14%	23%	
Të ketë sigurim/roje në shkollë*			22%	10%
Të ketë më shumë kamera në shkollë, vëzhgim i kamerave		17%	15%	16%
Masa më të rrepta disiplinore, përjashtimi nxënësve problematik nga shkolla		9%		7%
Ligjërata / aktivitete vetëdijësuese kundër dhunës dhe bullizmit	16%	6%		
Tualetet më të sigurta dhe më të pastra*	10%		5%	
Takime më të shpeshta me psikologun, të njoftohemi për problemet që sjellë dhuna		6%	10%	7%
Shkolla të jetë më e sigurtë, mos të ketë bullizim			10%	10%
Polic civil te shkolla	13%			
Gjithsej 197 nxënës	31	73	35	58

Tabela 9- Komuna Gjakovë

Kërkesa/ Sugjerimi i nxënësve	Hajdar Dushi	Hysni Zajmi	Selman Riza
Kontrolla të rregullta të nxënësve në klasa, në hyrje dhe çantat		15%	4%
Të ketë sigurim/roje në shkollë			13%
Të ketë më shumë kamera në shkollë, vëzhgim i kamerave			7%
Më shumë përkrahje nga arsimtarët / të marrin rastet më seriozisht	9%	18%	
Masa më të rrepta disiplinore dhe përjashtim i nxënësve problematik nga shkolla	13%		7%
Ligjërata / aktivitete vetëdijësuese kundër dhunës dhe bullizmit	21%		
Polic civil te shkolla		9%	
Gjithsej 112 nxënës	33	34	45

Po ashtu, nxënësit kanë shprehur edhe komente dhe kërkesa specifike, të cilat megjithëse nuk janë paraqitur shpesh, konsiderohen të rëndësishme për t'u evidentuar me qëllim të adresimit dhe sjelljes së këtyre shqetësimeve të nxënësve në vëmendje të institucioneve përgjegjëse. Në këto përgjigje shpërfaqen shqetësime të nxënësve lidhur me: sigurinë, higjienën, rregullat e shkollës etj.

Tabela 10 – Kërkesat dhe shqetësimet e nxënësve të paraqitura në pyetësor

Komuna	Shkolla	Shqetësimet/kërkesat kryesore të nxënësve	Fusha që preket
Pristinë	Ismail Qemali	Nxënësit kanë shprehur shqetësim për lokalet afër shkollës, ku dyshojnë se mund të shiten substanca të palejuara. Kanë kërkuar mbylljen e dyerve gjatë procesit mësimor dhe moslejimin e hyrjes së nxënësve nga shkolla të tjera.	Kontrolli i hyrje-daljeve; siguria rreth shkollës
Prishtinë	Sami Frashëri	Nxënësit kanë kërkuar që raportimet dhe shqetësimet e tyre të merren më seriozisht, të ketë masa më konkrete, rregulla më të rrepta sigurie dhe trajtim më serioz të rasteve të bullizmit.	Reagimi i shkollës; bullizmi; besimi në raportim
Prishtinë	Meto Bajraktari	Nxënësit kanë kërkuar masa më të rrepta ndaj nxënësve problematikë, vendosje të kamerave në klasa dhe prani të rojes. Po ashtu kanë theksuar se tualetet nuk janë të sigurta dhe se ka raste kur nxënësit mbajnë thika.	Masa disiplinore; kamera; siguria në tualete
Prishtinë	Andon Z. Çajupi	Nxënësit kanë kërkuar prani të policit civilcivilpolicisë civile, kontrolle të nxënësve dhe parandalim të bartjes së armëve të ftohta në shkollë.	Kontrolle parandaluese; prania e policisë
Ferizaj	Faik Konica	Nxënësit kanë kërkuar vendosjen e dyerve në tualete për privatësi, prani të policit civilcivilpolicisë civile, ngrohje më të mirë dhe pastrim më të rregullt të klasave dhe tualeteve.	Higjiena; privatësia; siguria; kushtet fizike
Ferizaj	Gjon Sereçi	Nxënësit kanë kërkuar më shumë seanca dhe ligjërata me psikologun, vetëdijesim kundër bullizmit, sjellje më të mirë nga arsimtarët, njoftim me psikologun, kontrolle në shkollë dhe tualete më të pastra.	Mbështetje psikologjike; bullizmi; higjiena; kontrollet
Ferizaj	Naim Frashëri	Nxënësit kanë kërkuar roje në secilin kat dhe te dera e shkollës, mbyllje të dyerve dhe mbrojtje më të madhe për fëmijët më të dobët apo të pambrojtur.	Roje; kontroll i qasjes; mbrojtja e nxënësve të cënueshëm
Gjakovë	Selman Riza	Nxënësit kanë kërkuar që arsimtarët të qëndrojnë afër klasave gjatë pushimit të gjatë, të ndalohet bullizmi, kërcënimi, përjashtimi nga grupet dhe injorimi nga bashkëmoshatarët. Kanë kërkuar edhe roje te dera e klasës, kamera në klasë dhe kujdestarë më aktivë.	Mbikëqyrja gjatë pushimeve; bullizmi; kamera; roje
Gjakovë	Hysni Zajmi	Nxënësit kanë kërkuar ndalimin e vizitave nga jashtë, ndalimin e daljeve nga shkolla gjatë procesit mësimor dhe bashkëpunim më të shpeshtë me Policinë.	Kontrolli i hyrje-daljeve; bashkëpunimi me Policinë

3.3 Rastet e dhunës në shkolla nuk janë trajtuar në mënyrë efektive

Të gjitha rastet e dhunës të paraqitura në shkolla duhet të shqyrtohen menjëherë nga drejtori i Institucioni Arsimor për Arsimin parauniversitar dhe atë duke pasur parasysh çdo herë interesin më të lartë të fëmijës. Institucioni për arsimin parauniversitar duhet të trajtojë rastin deri në zgjidhjen e tij¹³. Drejtori i institucionit cakton menaxherin/përgjegjës të rastit, që do të jetë përgjegjës të përcjellë rastin deri në mbyllje, ndërsa me trajtimin e vet rastit merren ekipet profesionale adekuate¹⁴.

Për të vlerësuar trajtimin e rasteve të dhunës në shkolla, janë analizuar evidencat fizike të shkollave të përfshira në auditim. Është vërejtur se rastet më serioze të dhunës zakonisht raportohen te drejtori i shkollës dhe trajtohen me përfshirjen e kujdestarit të klasës, psikologut dhe prindërve. Megjithatë, mënyra e trajtimit të rasteve ndryshon nga një shkollë në tjetrën. Shkollat dokumentojnë kryesisht rastet më serioze, ndërsa rastet e bullizmit dhe format tjera të dhunës psikologjike apo sociale shpesh nuk evidentohen dhe nuk trajtohen në mënyrë të dokumentuar. Për më tepër, janë gjetur raste serioze që nuk janë identifikuar nga vetë shkollat, por janë raportuar nga prindërit në polici të cilët kanë njoftuar edhe shkollën lidhur me rastin.

Nga pyetësorët me nxënës, rezulton se lloji më i shpeshtë i dhunës që kanë përjetuar është verbale (fyerje dhe tallje). Në vijim kemi paraqitur përgjigjet e nxënësve në pyetësor lidhur me pyetjen:

“A keni përjetuar bullizim apo ngacmim në shkollë? dhe çfarë lloji të dhunës?”

Grafiku 3- Përqindja e nxënësve që janë deklaruar se përjetuar bullizim dhe ngacmime në shkollë




Tabela 11- Lloji i bullizmit që kanë përjetuar

Nëse po, çfarë lloji	Ferizaj	Gjakovë	Prishtinë
Verbal (fyerje, tallje)	60%	49%	55%
Fizik (shtyerje, goditje)	28%	32%	17%
Online (cyberbullying)	3%	5%	6%
Social (përrjashtim nga grupet, përhapje e thashethëmeve)	8%	8%	6%
Të gjitha më lartë	0%	5%	15%

¹³ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, Neni 21, pika 1 dhe pika 2

¹⁴ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, Neni 21, pika 4

Sikurse shihet në masë më të theksuar është bullizmi verbal në krahasim me atë fizik, mirëpo për këtë lloj bullizmi shkollat ende nuk kanë ndërtuar struktura dhe procedura të mirëfillta që ta adresojnë dhe ta trajtojnë.

Nga evidencat fizike që kanë dërguar 30 shkollat që ishin mostër e auditimit për vitin 2022-2025¹⁵ kemi pranuar rastet si në vijim:

- Komuna e Prishtinës 230 raste në 13 shkolla,
- Komuna e Ferizaj 198 raste në 10 shkolla,
- Komuna e Gjakovës 107 raste në 7 shkolla.

Shumica e rasteve të dokumentuara nga shkollat janë raste serioze të dhunës, si: përleshje fizike, përdorim i mjeteve të mprehta, lëndime trupore, kërcënime dhe shantazhe, shpërndarje të fotografive dhe video-incizimeve në rrjete sociale.

Trajtimi i rasteve nga shkollat është kryesisht reagues dhe i fokusuar në masa disiplinore dhe biseda me nxënësit dhe prindërit, drejtorin dhe kujdestarin. Nuk janë identifikuar plane të strukturuara për trajtimin, rehabilitimin dhe përcjelljen afatgjatë të rasteve. Gjithashtu shkollat nuk kanë caktuar personin përgjegjës të rastit që të përcjellë rastin deri në zgjidhje, si dhe nuk kanë caktuar ekipe profesionale të dedikuara për trajtimin e rasteve ashtu sikurse kërkohet me rregulloren për protokollin. Gjithashtu, nuk kanë hartuar planin e mbrojtjes që kërkohet me udhëzuesin për zbatimin e rregullores. Për më tepër, shkollat nuk përmbushin kërkesën e rregullores që rastet të trajtohen deri në zgjidhjen e tyre sepse në situatat kur rastet janë referuar nga shkolla qoftë në policinë e Kosovës, qoftë në qendra për punë sociale nuk ka çdo herë informacione mbi zgjidhjen e rastit.

Në evidencat fizike të rasteve nga shkollat mostër, vërehet se nuk ka të dhëna të plota për paraqitjen e rasteve të dhunës në shkollë, pra shkollat nuk kanë listë që tregojnë se: sa raste janë trajtuar brenda shkollës, sa janë referuar në Polici, sa janë referuar në QPS, çfarë masa janë ndërmarrë, a është përcjellë rasti pas referimit, a është mbyllur rasti, a ka pasur efekt masa e ndërmarrë.

Gjithashtu, mungon dokumentimi i referimit të rasteve, kjo për arsye se MASHTI nuk kishte hartuar formularët e referimit në kuadër të rregullores për protokollin.

Po ashtu është vërejtur se mënyra e trajtimit dhe dokumentimit të rasteve të dhunës nuk është e standardizuar.

Disa shkolla kanë ofruar dosje të plota dhe kanë ndjekur në masë të lartë kërkesat e protokollit, ndërsa një pjesë tjetër kanë ofruar vetëm përshkrime të përgjithshme, vendime për masa disiplinore ose nuk kanë ofruar dokumentacion të mjaftueshëm për mënyrën e trajtimit të rasteve.

Tabela në vijim paraqet në detaje formën se si shkollat që ishin mostër auditimit kanë trajtuar rastet, numrin e raportimeve në SMIA krahasuar me numrin e rasteve në polici për këto shkolla.

Siç shihet nga tabela, në të tri komunat ka dallime të theksuara në mënyrën se si shkollat dokumentojnë dhe trajtojnë rastet e dhunës. Vetëm një pjesë e shkollave kanë dëshmuar se ndjekin

¹⁵ Janë 3 vite shkollore: 2022/2023; 2023/2024; 2024/2025

në masë të lartë kërkesat e protokollit, ndërsa pjesa tjetër mbështetet në praktika individuale, masa disiplinore ose dokumentim të kufizuar.

Tabela 12- Numri i rasteve të dhunës dhe bullizmit në shkollat mostër dhe trajtimi i tyre në tri komunat e audituara

Komuna	Shkolla në mostër	Raste në SMIA	Raste në evidenca fizike	Raste në raportet e Policisë	Niveli i dokumentimit dhe trajtimit të rasteve
Prishtinë	13	37	230	127	3 shkolla kanë ndjekur pothuajse plotësisht kërkesat e protokollit; 4 shkolla kanë respektuar pjesërisht protokollin; 4 shkolla kanë ofruar vetëm përshkrime/informata të përgjithshme; 2 shkolla nuk kanë ofruar dokumentacion për rastet e dhunës.
Ferizaj	10	17	198	37	2 shkolla kanë ndjekur në masë të lartë kërkesat e protokollit; 4 shkolla kanë trajtuar rastet serioze përmes praktikave individuale, kryesisht me procesverbale dhe masa disiplinore; 1 shkollë ka ofruar vetëm informata të përgjithshme; 3 shkolla kanë ofruar kryesisht vendime për masa disiplinore.
Gjakovë	7	25	107	49	2 shkolla kanë ndjekur në masë të lartë kërkesat e protokollit; 4 shkolla kanë treguar përpjekje për trajtimin e rasteve, por dokumentimi kryesisht është kufizuar në masa disiplinore dhe procesverbale; 1 shkollë nuk ka ofruar dokumentacion për trajtimin e rasteve.

Ndërsa në pyetjen ndaj nxënësve **“A mendon se reagon shkolla si duhet kur ndodh një incident?”** vetëm 38%-54% janë përgjigjur se shkolla reagon si duhet kur ndodhë një incident.

Tabela 13- Përgjigjet e nxënësve lidhur me reagimin e shkollës në rastet e incidenteve

A mendon se reagon shkolla si duhet kur ndodh një incident?	Ferizaj	Gjakovë	Prishtinë
Po	54%	49%	38%
Ndonjëherë	20%	20%	25%
Varësisht nga stafi (mësimdhënësi)	15%	23%	21%
Jo	11%	8%	16%

Sikurse shihet nga tabela, në të gjitha komunat e audituara, nga nxënësit që kanë marrë pjesë në pyetësor më pak se gjysma e tyre janë përgjigjur se shkolla reagon si duhet kur ndodhë një incident.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak se rregullorja për protokollin nuk është zbatuar nga shkollat. Gjithashtu për shkak të paqartësive në rregullore nuk përcakton nëse shkollat duhet të kenë të themeluar një ekipë të dedikuar e cila angazhohet për trajtimin dhe zgjidhjen e gjitha rasteve të dhunës në shkollë, apo duhet të caktohet një ekipë e veçantë në secilin rast veçanërisht.

Për më tepër, shumica e shkollave nuk përdorin sistemin SMIA për raportim të rasteve të dhunës. Po ashtu edhe për shkak se DKA dhe MASHTI nuk kanë bërë monitorimin e shkollave për zbatimin e rregullores së protokollit.

Për pasojë, intervenimet fokusohen më shumë në menaxhimin momental të incidentit sesa në adresimin e shkaqeve dhe parandalimin e përsëritjes së rasteve. Po ashtu, dokumentimi i rasteve në shkolla nuk është i plotë dhe i standardizuar, duke e bërë të vështirë përcjelljen, monitorimin dhe vlerësimin e efektit të masave të ndërmarra. Kjo njëkohësisht dobëson mbrojtjen e viktimave dhe zvogëlon mundësinë për parandalimin e përsëritjes së rasteve të dhunës.

3.4. Të dhënat e raportuara nga shkollat nuk janë të sakta dhe të besueshme

Drejtori i institucionit të arsimit parauniversitar është përgjegjës për raportimin e të dhënave statistikore për rastet e dhunës bazuar në regjistrin e rasteve përkatëse raporton në DKA, ky raportim bëhet dy herë në vit. Gjithashtu edhe raportimi në MASHTI bëhet dy herë në vit¹⁶.

Aktualisht, institucionet përgjegjëse nuk kanë të dhëna të plota dhe të sakta për numrin e incidenteve të dhunës në shkolla. Të dhënat e raportuara në SMIA janë dukshëm më të ulëta se rastet e evidentuara në raportet e Policisë së Kosovës dhe në evidencat fizike të shkollave.

Për periudhën 2022-2025, në SMIA janë raportuar gjithsej 117 raste të dhunës në nivel vendi, ndërkaj për periudhën e njëjtë kohore në raportet e Policisë figurojnë mbi 2,300 raste që lidhen me nxënësit dhe mjedisin shkollor. Nga gjithsej 970 shkolla¹⁷ të arsimit parauniversitar në nivel vendi, numri maksimal i shkollave që kanë raportuar rastet e dhunës në SMIA është gjithsej 17 shkolla apo vetëm 2% e shkollave në Kosovë. Të dhënat e detajuara për secilën komunë dhe rajon i gjeni në *Shtojcën 2- Numri i rasteve sipas raporteve të Policisë dhe SMIA-tabela 18 dhe 19.*

Institucionet e arsimit në nivel qendror dhe lokal janë deklaruar se rastet e raportuara në Policinë e Kosovës nuk janë raste që ndodhin në shkolla, por konflikte që ndodhin jashtë mjediseve shkollore. Për të vërtetuar këto deklarime kemi analizuar periudhën kohore kur kanë ndodhur incidentet e raportuara në Policinë e Kosovës si dhe palët e përfshira në konflikt.

Në të dyja analizat shihet se rastet e paraqitura në raportet e PK-së janë raste që ndodhin në shkolla ose në afërsi.

Kjo pasi që duke analizuar palët e përfshira në konflikte, nga totali i incidenteve të paraqitura nga policia e Kosovës shihet se deri në 70% të këtyre incidenteve janë konflikte që kanë ndodhur mes nxënësve apo konflikte nxënës-arsimtar (*Shih shtojca 2- Numri i rasteve sipas raporteve të Policisë-tabela 20*). Ndërsa pjesa tjetër e incidenteve janë raste të ndërlidhura si: dëmtim i pronës së shkollës dhe vjedhje.


¹⁶ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, Neni 25, pika 6 dhe Neni 26, pika 5

¹⁷ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2024-2025, MASHTI

Gjithashtu nga analiza e periudhës kur kanë ndodhur incidentet shihet se gjatë muajve korrik dhe gusht, kur nxënësit janë në pushim ndodhin deri 15 incidente në muaj. Ndërsa gjatë muajve kur zhvillohet procesi mësimor, numri i incidenteve sillet nga 50 deri në 90 raste për muaj. Kjo tregon një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet incidenteve të raportuara dhe periudhës së vitit shkollor.

Grafiku në vijim paraqet numrin e incidenteve të dhunës gjatë muajve kur zhvillohet procesi dhe pushimeve verore.

Grafiku 4- Incidentet e dhunës të shprehura për muaj të vitit (burimi: Policia e Kosovës)



Për më tepër vetëm nga 30 shkollat që ishin mostër auditimi për periudhën 2022-2025 kemi pranuar 535 raste të dhunës në evidencat fizike të shkollës, që tregon se shkollat kanë raste të dhunës por raportimi i tyre nuk bëhet, pra shkollat nuk kanë raportuar në DKA dhe as në SMIA siç kërkohet me rregulloren për protokollin dhe udhëzuesin për zbatimin e kësaj rregullore.

Sipas sqarimeve të dhëna nga shkollat, mos raportimi i rasteve të dhunës në SMIA ka ardhur kryesisht për shkak se rastet janë trajtuar dhe menaxhuar brenda shkollës ose në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse, pa u konsideruar i nevojshëm raportimi në sistem.

Gjithashtu, shkollat kanë evidentuar paqartësi dhe mungesë të njohurive lidhur me obligimet dhe procedurat e raportimit në SMIA, përfshirë perceptimin se raportimi kryhej nga institucione të tjera ose vetëm për kategori të caktuara të nxënësve.

Në disa raste, mos raportimi është ndikuar nga mungesa e qasjes në sistem, problemet teknike, ndryshimet në personelin përgjegjës dhe shqetësimet lidhur me ruajtjen e privatësisë së nxënësve.

Megjithatë, sipas analizave që kemi bërë kjo situatë, lidhet po ashtu edhe me boshllëqet dhe mos harmonizimin e rregullores për Protokollin të aprovuar në vitin 2013 dhe udhëzuesin për zbatimin e kësaj rregullore i cili ishte hartuar në vitin 2015.

Mos përputhja mes këtyre dy dokumenteve ka krijuar boshllëqe, sepse rregullorja kërkon që drejtori i shkollës të evidentojë të gjitha rastet e dhunës në regjistrin fizik përkatës dhe t'i dorëzojë këto të dhëna në DKA dy herë në vit, përderisa udhëzuesi kërkon që drejtori i shkollës të raportojë

menjëherë, në mënyrë elektronike, përmes sistemit SMIA e cila ka zëvendësuar raportimin përmes regjistrave fizikë.

Për pasojë, MASHTI dhe DKA-të nuk kanë një pasqyrë reale të shkallës së dhunës në shkolla. Mungesa e të dhënave të sakta dhe të konsoliduara e vështirëson identifikimin e shkollave dhe komunave me rrezik më të lartë, planifikimin e masave parandaluese, monitorimin e zbatimit të protokollit dhe vlerësimin e efektivitetit të masave të ndërmarra për sigurinë e nxënësve.

Numri i rasteve dhe raportimet në Komunitet e audituara

Sikurse në nivel nacional e njëjta situatë sa i përket raportimit të rasteve të dhunës edhe në tri komunitet që ishin mostër e auditimit. Pra, shkollat nuk kanë përdorur sistemin SMIA për të raportuar të gjitha rastet e dhunës dhe dukurive tjera negative në shkolla.

Në tabelën në vijim është paraqitur numri i rasteve të raportuar në SMIA në gjitha shkollat e komunave përkatëse si dhe të dhënat sipas raporteve nga Policia e Kosovës.

Të dhënat janë për tri komunitet që ishin pjesë e auditimit, por në numrin e shkollave nuk janë përfshirë edhe paralelet e ndara fizike: Prishtinë (56 shkolla), Ferizaj (47 shkolla) dhe Gjakovë (46 shkolla).

Tabela 14- Numri i rasteve të raportura në polici për periudhën 2022-2025 për tri komunitet e audituara

Komuna	Numri i shkollave në komunitet e audituara (nuk janë përfshirë paralelet e ndara fizike)	Rastet në polici të gjitha shkollat	Raportime në SMIA-të gjitha shkollat
Prishtinë	56	415	44
Ferizaj	47	96	17
Gjakovë	46	133	27
Gjithsej	N/A	644	88

Të tri komunitet bashkërisht në SMIA kanë raportuar gjithsej 88 raste për vitet 2022-2025¹⁸ ndërsa nga evidencat fizike vetëm për 30 shkollat mostër në kuadër të këtyre komunave kemi identifikuar se kanë qenë 535 raste të llojeve të ndryshme të dhunës në shkolla.

Tabela në vijim për periudhën 2022-2025 paraqet të dhëna të detajuara për gjitha shkollat e këtyre tri komunave lidhur me raportimet në SMIA dhe për natyrën e rasteve nga të dhënat nga raportet e policisë.

¹⁸ Këto janë vitet shkollore 2022/2023; 2023/2024 dhe 2024/2025

Tabela 15 - Raportimet në SMIA krahasuar me numrin e incidenteve nga të dhënat e policisë dhe natyra e incidenteve (të gjitha shkollat në nivel komune)


Komuna	Raportimi në SMIA	Të dhënat nga Policia e Kosovës	Llojet kryesore të incidenteve	Problemet kryesore të identifikuar
Prishtinë	Nga 56 shkolla, vetëm 8 shkolla kanë raportuar në SMIA gjithsej 44 raste. Prej tyre, 21 raste apo 47% janë raportuar nga një shkollë e vetme – “Meto Bajraktari”.	Sipas Policisë së Kosovës, në shkollat e komunës së Prishtinës janë evidentuar 415 incidente të dhunës gjatë periudhës 2022–2025.	• Lëndim i lehtë trupor – 94 raste • Posedim i paautorizuar i armëve, kryesisht thika – 86 raste • Sulm – 69 raste • Kanosje – 20 raste • Nga 415 incidente, 269 apo 65% janë incidente me seriozitet të lartë.	Shkollat nuk kanë raportuar në SMIA në mënyrë të plotë; nuk kanë bërë raportime periodike në DKA; DKA nuk ka raportuar në MASHTI. Si rezultat, DKA dhe MASHTI nuk kanë statistika të sakta dhe të besueshme për rastet e dhunës në shkolla.
Ferizaj	Nga 47 shkolla, vetëm shkolla “Naim Frashëri” ka raportuar në SMIA, gjithsej 17 raste për vitet shkollore 2022–2025. Shkollat tjera nuk kanë raportuar asnjë rast.	Sipas Policisë së Kosovës, në shkollat e komunës së Ferizajt janë evidentuar 96 incidente të dhunës.	• Përleshje fizike/lëndim i lehtë trupor – 28 raste • Dëmtim i pasurisë së shkollës – 18 raste • Posedim i paautorizuar i armëve, kryesisht thika – 15 raste • Sulm dhe kanosje – 8 raste • Rastet tjera përfshijnë therje me thikë, keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe posedim të substancave narkotike.	Vërehet dukuri e theksuar e dëmtimit të pronës së shkollës, hyrje të personave të paautorizuar në shkollë/oborr, vjedhje dhe dëmtime të kamerave, kompjuterëve dhe pajisjeve tjera. Këto raste nuk janë evidentuar në raportet zyrtare të shkollave apo DKA-së. DKA nuk ka raportuar në MASHTI në baza vjetore.
Gjakovë	Nga 46 shkolla, vetëm 3 shkolla kanë raportuar në SMIA gjithsej 35 raste për vitet shkollore 2022–2025. Prej tyre, 29 raste apo 83% janë raportuar nga një shkollë e vetme.	Sipas Policisë së Kosovës, nga 46 shkolla, në 27 shkolla janë evidentuar incidente të dhunës, gjithsej 133 raste gjatë periudhës 2022–2025.	• Përleshje fizike/lëndim i lehtë trupor – 42 raste • Posedim i paautorizuar i armëve, kryesisht thika – 32 raste • Kanosje – 16 raste • Vjedhje e rëndë – 15 raste • Posedim i substancave narkotike – 10 raste • Sulm – 9 raste.	Dy dukuritë më të theksuara janë lëndimet trupore dhe posedimi i paautorizuar i armëve të ftohta. Shkollat nuk kanë raportuar në SMIA dhe nuk kanë bërë raportime periodike në DKA. Po ashtu DKA nuk ka raportuar në MASHTI, prandaj nuk ka pasqyrë të saktë të rasteve të dhunës në shkolla.

Pra sikurse shihet edhe pse ka pasur incidente të ndryshme të dhunës, të njëjtat nuk janë raportuar në SMIA nga ana e shkollave.

Se shkollat kanë pas më shumë raste se sa që janë raportuar dëshmohet edhe nga përgjigjet e pranuar nga nxënësit në pyetësor ku në Prishtinë 30% e nxënësve janë deklaruar se kanë qenë viktimë apo dëshmitar të dhunës në shkollë, në Ferizaj 24% ndërsa në Gjakovë 17%.

Në vijim janë përgjigjet e nxënësve lidhur me pyetjen **“A ka qenë dëshmitar apo viktimë e dhunës?”**

Grafiku 5- Përqindja e nxënësve që janë deklaruar se kanë qenë dëshmitarë apo viktimë e dhunës



Pra edhe përgjigjet e nxënësve tregojnë se shkalla e rasteve të dhunës në shkolla është më shumë e theksuar se sa ajo që raportohet nga shkollat.

Lidhur me raportimet në SMIA, nga janari deri në prill 2026, që është periudha pas fillimit të fazës së ekzekutimit të auditimit në komunën e Prishtinës, është vërejtur një rritje e konsiderueshme e raportimit të rasteve në sistemin SMIA. Gjatë kësaj periudhe janë raportuar 34 raste të reja, ndërsa numri i shkollave që kanë raportuar raste është rritur nga 8 në 16 shkolla. Pra, tetë shkolla që më herët nuk kishin raportuar asnjë rast në SMIA, kanë raportuar gjithsej 28 raste vetëm gjatë tre muajve të parë të vitit 2026.

Ky zhvillim tregon se mungesa e raportimit në SMIA nuk është për shkak se nuk ka incidente të dhunës në shkolla, por për shkak të mos përdorimit të sistemit të raportimit nga shkollat dhe paqartësive që kanë shkollat. Njëkohësisht, numri prej 34 raportimeve paraqet nivelin më të lartë të raportimeve të regjistruara ndonjëherë në SMIA nga shkollat e Prishtinës dhe atë vetëm gjatë tre muajve. Për krahasim, deri në Dhjetor 2025 numri më i lartë i raportimeve gjatë një viti shkollor kishte qenë 18 raste në vitin shkollor 2023/2024.

Ky ndryshim tregon se ka pas rritje të vëmendjes institucionale rreth raportimit të rasteve në SMIA.

Rregullorja për protokollin dhe udhëzuesi i klasifikon llojet e dhunës sipas intensitetit duke i ndarë në tri shkallë si në vijim: shkalla 1- intensitet më i lehtë, shkalla 2-intensitet i mesëm i dhunës dhe shkalla 3-intensitet i lartë i dhunës. Megjithatë as në rregullore dhe as në udhëzues nuk është e përcaktuar se cila nga shkallët e dhunës raportohet në SMIA.

Gjithashtu në rregullore nuk specifikohet se shkollat obligohen të raportojnë në SMIA, pavarësisht nëse rasti është referuar në institucionet tjera apo është zgjidhur nga shkollat. Kjo ka shkaktuar paqartësi te shkollat sa i përket raportimit të rasteve.

Përveç paqartësive lidhur me obligimin për raportim, edhe vetë moduli i SMIA-s ka kufizime funksionale që nuk e mbështesin plotësisht menaxhimin dhe gjurmimin e rasteve sikurse janë:

- nuk mundëson regjistrimin e një incidenti si rast të vetëm kur janë të përfshirë disa nxënës,
- nuk lejon ngarkimin e dokumentacionit mbështetës dhe
- nuk ka shabllone standarde për dokumentimin e hapave të trajtimit dhe mbylljes së rastit.

Si rezultat, shkollat vazhdojnë të mbajnë dosje fizike të ndara nga raportimi elektronik, ndërsa DKA-të dhe MASHTI kanë mundësi të kufizuara për të gjurmuar, verifikuar dhe monitoruar trajtimin e rasteve të raportuara.

Këto kufizime lidhen me faktin se moduli i raportimit të dhunës në SMIA nuk është përditësuar dhe përshtatur që nga zhvillimi i tij, për të mbështetur në mënyrë efektive nevojat e shkollave dhe institucioneve mbikëqyrëse. Kjo ka shkaktuar pa qartësi për shkollat lidhur shkallën e dhunës që duhet të raportohet në SMIA.

Si përfundim, për të kuptuar arsyet e mos raportimit të rasteve në SMIA, nga 30 shkollat që ishin mostër auditimi kemi pranuar me shkrim sqarime individuale lidhur me këtë çështje.

Shkaku i mos raportimit të incidenteve në SMIA lidhet kryesisht me paqartësitë e shkollave për obligimet dhe mënyrën e raportimit. Shkollat kanë interpretuar në mënyra të ndryshme rastet që duhet të raportohen: disa kanë konsideruar se rastet e trajtuara brenda shkollës nuk duhet të regjistrohen në SMIA, disa të tjera se rastet e referuara në Policinë e Kosovës nuk kërkojnë raportim shtesë në SMIA, ndërsa disa kanë menduar se raportimi në MASHTI bëhet nga DKA.

Megjithatë arsyeja kryesore e cila ka ndikuar që raportimi të mos jetë i plotë dhe i njëtrajtshëm është mungesa e udhëzimeve të qarta dhe mungesa e monitorimit nga DKA-të ndaj drejtorëve të shkollave. Gjithashtu nuk ka pas as inspektime nga MASHTI që ka rezultuar me mungesë të llogaridhënies. Si rezultat, shkollat kanë zhvilluar praktika të ndryshme të menaxhimit dhe raportimit të rasteve, duke krijuar boshllëqe në procesin e raportimit në SMIA.

Për pasojë, institucionet përgjegjëse nuk posedojnë të dhëna të besueshme dhe të konsoliduara për nivelin real të dhunës në shkolla. Kjo vështirëson monitorimin e situatës, identifikimin e shkollave apo komunave me nivel më të lartë të rrezikut, si dhe planifikimin e politikave dhe masave efektive apo planeve të sigurisë për parandalimin dhe trajtimin e dhunës. Po ashtu, mungesa e të dhënave të sakta dobëson mbikëqyrjen institucionale dhe pamundëson vlerësimin e efektivitetit të masave të ndërmarra nga shkollat dhe institucionet përgjegjëse. Njëkohësisht bën të pa mundur të klasifikohen llojet e dhunës, shpeshtësia, ushtruesit e dhunës, viktimat etj.

3.5 Policia nuk ka standardizuar procesin e raporteve kthyesë për shkollat

Institucionet përgjegjëse duhet që në planet zhvillimore dhe në plane të veprimit të përcaktojnë objektiva, masa dhe aktivitete sistematike që kontribuojnë në parandalimin e të gjitha llojeve të dhunës¹⁹. Të realizojë patrulla të rregullta veçanërisht rreth shkollave ku vërehen dukuri negative dhe të caktojë përfaqësues të saj kontaktues me institucionin e arsimit²⁰.

Policia e Kosovës ka zhvilluar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve, si në aspektin e parandalimit ashtu edhe në reagimin ndaj rasteve të dhunës dhe bullizmit nga nxënësit në shkolla dhe në hapësirat publike përreth tyre. Veprimet që Policia i realizon sa i përket sigurisë në shkolla janë të përfshira edhe në kuadër të Strategjisë 2021-2025²¹.

Në kuadër të kësaj strategjie është një objektivë e veçantë e titulluar “Menaxhimi i Sigurisë në Shkolla”.

Në kuadër të objektivit parashihen veprimet si në vijim nga ana e PK:

- Organizimi i takimeve periodike me DKA-të, lidhur me sigurinë në shkollë
- Organizimi i ligjëratave dhe fushatave vetëdijësuese lidhur me dukuritë negative
- Parandalimi i futjes së substancave narkotike në institucione arsimore
- Identifikimi i kërcënimeve fizike për rreth shkollave
- Përkrahja në hartimin e planeve të evakuimit në objektet shkollore

Nga analizimi i aktiviteteve të Policia e Kosovës në tri komunat e audituara është vërejtur se stacionet policore kanë të përcaktuara shkollat që mbulojnë dhe kanë hartuar plane të veprimit për sigurinë në shkolla në kuadër të Urdhrit Operativ “Fillimi i vitit shkollor dhe siguria në shkolla”.

Planet përfshijnë angazhimin e zyrtarëve policorë për parandalimin dhe trajtimin e dukurive negative në shkolla dhe rreth tyre.

Nga analiza e raporteve dhe procesverbaleve është identifikuar se aktivitetet e planifikuara realizohen, raportimet bëhen në baza të rregullta javore dhe mujore, ndërsa policia zhvillon takime të shpeshta dhe të vazhdueshme me shkollat. Tabela e aktiviteteve e paraqitur në ***Shtojca 2-Numri i rasteve të policisë dhe SMIA (tabela numër 21)***.

Gjatë auditimit është identifikuar se Policia e Kosovës ka bashkëpunim të rregullt me institucionet përgjegjëse për sigurinë në shkolla, përfshirë MASHTI-n, DKA-të, shkollat dhe QPS-të. Ky bashkëpunim është konfirmuar edhe nga drejtorët e shkollave në tri komunat e audituara, të cilët kanë theksuar se Policia i përgjigjet kërkesave të shkollave dhe është e pranishme në aktivitete parandaluese.

Në kuadër të ligjëratave vetëdijësuese, Policia ka trajtuar tema të ndryshme që lidhen me sigurinë dhe dukuritë negative në shkolla. Në vijim janë paraqitur ligjëratat me pjesëmarrjen më të lartë dhe që lidhen drejtpërdrejt me parandalimin e dhunës në shkolla.

¹⁹ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, neni 6, pika 1.3

²⁰ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, neni 13, pika 1.4 dhe 1.5

²¹ Strategjia e integruar e policimit të drejtuar nga intelijenca dhe policimit në bashkësi

Tabela 16- Ligjëratat për parandalimin dhe vetëdijesimin kundër dhunës dhe dukurive negative në shkolla nga Policia e Kosovës

Komuna	Prishtinë			
Tema e ligjëratave	2024		2025	
	Numri i shkollave	Numri i nxënësve	Numri i shkollave	Numri i nxënësve
1.Bullizmi dhe masat parandaluese	41	2481	78	4121
2.Pasojat e përdorimit të Narkotikëve	43	3376	83	2571
3.Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të Internetit	31	1729	26	4172
4.Rreziqet dhe pasojat e armëbajtjeve në mjediset shkollore	N/A	N/A	10	460
Komuna	Ferizaj			
1.Bullizmi dhe masat parandaluese	20	884	46	2380
2.Pasojat e përdorimit të Narkotikëve	30	1050	30	1305
3.Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të Internetit	N/A	N/A	26	1088
Komuna	Gjakovë			
1.Bullizmi dhe masat parandaluese	12	413	15	728
2.Pasojat e përdorimit të Narkotikëve	14	544	11	323
3.Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të Internetit	20	863	13	466

Sipas sqarimeve të pranura nga Policia e Kosovës, temat e ligjërimeve përcaktohen në bashkëpunim me MASHTI, bazuar në trendet e krimit dhe dukuritë negative në shkolla. Përzgjedhja e shkollave bëhet nga DKA-të, ndërsa përzgjedhja e nxënësve pjesëmarrës realizohet nga menaxhmenti i shkollës. Përkundër ligjëratave të shpeshta, as këto ligjërata nuk janë gjithëpërfshirëse dhe nuk përfshijnë çdo herë të gjithë nxënësit e shkollës. Sipas shkollave kjo ndodhë për shkak të kufizimeve të ambientit, vështirësive në organizimin e ligjëratave me grupe të mëdha të nxënësve, njëkohësisht gjë që ndikon që shkollat të zgjedhin për pjesëmarrje në ligjërata nxënës të caktuar duke u bazuar në temën e ligjëratës dhe nevojave të nxënësve.

Gjatë auditimit është identifikuar se procedurat e komunikimit dhe informimit ndërmjet Policisë dhe shkollave nuk janë të përcaktuara qartë. Kjo vlen si për rastet kur shkolla kërkon ndërhyrjen e Policisë, ashtu edhe për rastet kur Policia identifikon nxënës të përfshirë në veprime të rrezikshme apo të ndaluara jashtë shkollës. Edhe pse Policia, përmes planeve të veprimit, cakton zyrtarë policorë përgjegjës për shkolla në kuadër të secilit stacion policor, forma dhe përmbajtja e raportimit kthyes ndaj shkollave nuk është standardizuar.

Si rezultat, janë zhvilluar praktika të ndryshme: në disa raste shkollat informohen për veprimet e ndërmarra ndaj nxënësve të përfshirë në incidente, ndërsa në raste të tjera nuk pranojnë informacion pas referimit të rastit në Polici.

Mungesa e raportimit kthyes ndodh për shkak se nuk është përcaktuar në mënyrë specifike se si duhet të veprohet në këto raste. Në shumë raste, Policia e Kosovës vepron duke i dhënë prioritet ruajtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës.

Megjithatë, mungesa e raportimit të standardizuar kthyes ndikon që shkollat të mos informohen mbi hapat dhe veprimet e ndërmarra lidhur me nxënësit e përfshirë në incidente. Si rezultat, dobësohet koordinimi ndërinstitutional dhe ndikon që secili institucion të veprojë i pavarur duke përdorur mekanizmat që posedon. Në këtë mënyrë edhe vështirësohet ndërmarrja e veprimeve të përbashkëta për trajtimin, rehabilitimin dhe zgjidhjen afatgjatë të problemeve të identifikuara të nxënësve.

3.6 Qendrat për punë sociale nuk sigurojnë trajtim të vazhdueshëm dhe përgjigje të rregullt për rastet e referuara nga shkollat

Kur identifikohet një fëmijë që është ushtrues apo viktimë e dhunës dhe për çfarëdo arsye tjetër ka nevojë për pranimin e shërbimeve sociale, janë të obliguar të referojnë rastin në Qendër për Punë Sociale²². Menaxheri i rastit në qendra për punë sociale brenda 30 ditëve njofton me shkrim drejtorin e institucioni i arsimit para-universitar²³. Çdo qendër për punë sociale duhet të përcaktojë së paku një (1) zyrtar përkatës përgjegjës dhe të specializuar për të koordinuar masat dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës. Ushtron çdo kompetencë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi²⁴. Të mbrojnë të gjithë fëmijët në gjendje të nevojës sociale e edhe fëmijëve viktimë dhe ushtrues të dhunës²⁵.

Shkollat, në raste të caktuara, referojnë nxënësit në Qendrat për Punë Sociale për pranim të shërbimeve sociale, veçanërisht në rastet e nxënësve me sjellje asociale dhe problematike. Referimi realizohet pasi shkolla ka shteruar mekanizmat e brendshëm dhe bashkëpunimin me prindërit për mbështetjen emocionale dhe psikologjike të nxënësit.

Në komunën e Prishtinës funksionojnë tri Qendra për Punë Sociale nën menaxhimin e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale. Për të vlerësuar mënyrën e trajtimit të rasteve nga QPS, kemi analizuar katër raste të referuara nga shkollat në këtë komunë nga gjithsej 14 sa kishin referuar shkollat për vitet shkollore 2022/2023, 2023/2024 dhe 2024/2025 (sipas sistemit SMIA). Për tri raste janë pranuar dosjet përkatëse nga QPS, ndërsa për një rast nuk është pranuar dosja për shkak të mungesës së datës së referimit nga shkolla.

Rasti 1: Shkolla e kishte referuar nxënësin në QPS për sjellje asociale më 11 maj 2023, por nuk kishte pranuar përgjigje brenda afatit prej 30 ditësh, siç kërkohet me rregulloren për protokollin. Më pas, rasti ishte referuar përsëri nga drejtoresha e re e shkollës më 27 mars 2025, duke theksuar se shkolla kishte shteruar të gjitha mundësitë për trajtimin e nxënësit dhe se mungonte bashkëpunimi i familjes. Pas referimit të dytë, QPS kishte filluar trajtimin e rastit, por pas takimit me familjen kishte vlerësuar se nuk ka elemente të problemeve familjare apo neglizhencës. Në shtator 2025, shkolla për të njëjtin rast kishte kërkuar organizimin e një tryeze multidisciplinare me DKA dhe QPS, ndërsa edhe në këtë rast ishte vlerësuar se nxënësi nuk ka nevojë për shërbime nga QPS. Më pas, në mars

²² Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, neni 6, pika 1.7

²³ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, Neni 23

²⁴ Ligji nr 06 L-084 për mbrojtjen e fëmijës, neni 15, pika 1.4

²⁵ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, Neni 11, pika 1.2

2026, shkolla kishte dërguar përsëri kërkesë në QPS, e cila kishte konfirmuar pranimin e saj. Megjithatë, deri momentin kur ka qenë duke u realizuar auditimi ky rast nuk ka pas ndonjë zgjidhje.

Rasti 2: Rast me specifikën “i mitur në konflikt me ligjin” dhe vepër e rëndë, këtë rast shkolla e ka raportuar më datë 27 mars 2025 dhe QPS e kishte adresuar një ditë më vonë për trajtim. Në këtë rast, vepra ishte e rëndë duke përfshirë organizim për sulm në grup, megjithatë QPS ka ofruar vetëm shërbimet në vijim: ka zhvilluar **një vizitë** rreth gjendjes në shtëpi ku nuk kanë gjetur adresën e saktë të familjes, ka zhvilluar një vizitë në shkollë më datë 28 mars 2025 dhe ka realizuar **një konsultë**, për më tepër as prindi nuk kishte pranuar të takohet me QPS. Duke qenë se mosha ishte mbi 14 vjet, ka vazhduar ndjekja e procedurave tjera ligjore nëpërmjet prokurorit për të mitur, por nuk janë ofruar shërbime tjera nga QPS në mënyrë që të mbështesë tutje në përmirësimin e sjelljes.

Rasti 3: Ky rast me kërkesë të drejtoreshës së shkollës ishte referuar nga ana e Policisë për shkak të seriozitetit të rastit, referimi ishte bërë më datë 28 shkurt 2024. Në këtë rast QPS ka ofruar shërbime për këtë nxënës vetëm gjatë muajit mars dhe prill 2024 ku ishte përfshirë takimi në familje dhe seanca me psikologun e QPS, por edhe në këtë rast ishte ndërprerë shërbimi ndërsa në formularët e QPS nuk ka ndonjë sqarim shtesë lidhur me këtë. Nxënësi vijon ende mësimet në shkollë dhe vazhdon të shkaktojë probleme për menaxhim të sjelljeve në shkollë duke manifestuar sjellje asociale dhe kërcënime në drejtim të mësimitdhënësve.

Në anën tjetër, me anë të vendimit të komunës parashihet që për raste komplekse për të cilat shkollat kërkojnë mbështetje dhe koordinim institucional, QPS të organizojë tryeza multidisciplinare. Përgjatë viteve 2022–2025 është organizuar vetëm një tryezë multidisciplinare, megjithëse gjatë auditimit janë identifikuar edhe raste tjera komplekse. Gjithashtu të dhënat e regjistruara nga QPS nuk janë çdo herë të sakta, nga analiza e rasteve dhe evidencave të QPS është vërejtur se ka pasur raste të referuara nga shkollat por të paregjistruara nga QPS, gjithashtu ka vonesa në trajtim dhe mungesë të raporteve kthyesë për shkollat. Po ashtu, është identifikuar mungesë e koordinimit dhe komunikimit ndërmjet institucioneve, ndërsa rastet shpesh nuk janë trajtuar me kohë ose kanë humbur në proces. Në asnjërën nga tri Qendrat për Punë Sociale nuk ishte caktuar zyrtar i specializuar për koordinimin e rasteve të fëmijëve, personeli nuk ishte i profilizuar sipas fushave të trajtimit dhe nuk ishte dëshmuar monitorim i punës me fëmijët. Për pasojë, shkollat dhe nxënësit nuk kanë marrë mbështetjen dhe trajtimin e nevojshëm në kohë.

Sipas Qendrave për Punë Sociale kjo ka ndodhur për shkak se ato përballen me mungesë të theksuar të kapaciteteve infrastrukturore dhe njerëzore, si dhe me ngarkesë të madhe të punës, gjë që kufizon profilizimin e stafit dhe trajtimin efektiv të rasteve. Po ashtu, QPS kanë deklaruar se shkollat shpesh referojnë raste me informacione jo të plota ose raste që sipas tyre nuk janë brenda kompetencave të shërbimeve sociale. Megjithatë, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren për Protokollin, QPS obligohen të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë mbështetje edhe për rastet e fëmijëve me sjellje asociale, si dhe për fëmijët ushtrues apo viktime të dhunës, dhe jo vetëm në rastet e neglizhencës apo dhunës në familje.

Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional në trajtimin e rasteve të referuara nga shkollat ka bërë që shkollat të mbeten të kufizuara vetëm në mekanizmat e tyre të brendshëm për

menaxhimin e rasteve. Kjo ndodh për shkak se mungon zhvillimi i mekanizmave të përbashkët për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse si në nivel qendror ashtu edhe lokal.

Për pasojë, vështirësohet trajtimi efektiv dhe rehabilitimi i nxënësve me sjellje asociale, ndërsa rritet rreziku për përsëritje të incidenteve, bullizmit dhe dhunës në shkolla. Kjo situatë është veçanërisht problematike tek nxënësit nën moshën 14 vjeç, për të cilët shkollat mbeten institucioni kryesor që menaxhon rastet, shpesh pa mbështetje të mjaftueshme profesionale dhe multidisiplinare.

3.7 Drejtoritë komunale të arsimit nuk kanë qenë efektiv në vendosjen e mekanizmave dhe rolin e tyre monitorues dhe mbikëqyrës

Drejtoria Komunale e Arsimit duhet të zhvillojë hulumtime për gjendjen e të drejtave të fëmijës nga këndi i parandalimit dhe i mënjanimin të akteve dhe i veprimeve të dhunshme në të gjitha relacionet brenda institucioneve arsimore. Të bashkëpunojë me Policinë, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, me partnerë të tjerë dhe komunitetin, duke krijuar siguri brenda dhe përreth institucioneve arsimore. DKA-të duhet të miratojnë rregulloret e institucioneve arsimore dhe monitorojnë zbatimin e tyre²⁶. Drejtoria Komunale e Arsimit është përgjegjëse për sigurimin, përpunimin e të dhënave të pranuar nga institucionet arsimore.²⁷

Komunat në linjë me kompetencat e tyre hartojnë dhe aprovojnë dokumente strategjike lidhur me funksionimin e institucioneve të arsimit parauniversitar.

Komunat e audituara kanë ndërmarrë disa veprime për adresimin e sigurisë në shkolla, përfshirë hartimin e dokumenteve komunale, miratimin e rregulloreve të punës së institucioneve arsimore dhe angazhimin e një numri të psikologëve shkollorë. Megjithatë, këto masa nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar një qasje të njëtrajtshme, funksionale dhe efektive në parandalimin, trajtimin dhe monitorimin e rasteve të dhunës dhe sjelljeve problematike në shkolla.

Në Komunën e Prishtinës ishte hartuar Plani i veprimit për siguri në shkolla 2023–2026, i cili synonte adresimin e shumicës së problematikave të sigurisë. Megjithatë, plani nuk ishte zbatuar plotësisht, ndërsa disa objektiva ishin përmbushur vetëm pjesërisht ose vetëm në nivel të kufizuar të shkollave. Në Ferizaj, komuna kishte kontraktuar shërbime të rojës fizike, por ky shërbim nuk mbulonte të gjitha shkollat dhe nuk kishte të përcaktuara qartë detyrat e rojës në shkollë. Ndërsa në Gjakovë ishte hartuar rregullorja për kutinë e ankesave, por DKA nuk kishte kontrolluar nëse kjo rregullore zbatohet nga shkollat.

Përveç kësaj, shkollat nuk kanë pasur qasje të barabartë në shërbime profesionale mbështetëse. Në tri komunat e audituara ka ende shkolla pa psikolog ose me psikolog të angazhuar vetëm pjesërisht.

²⁶ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, Neni 8

²⁷ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, Neni

Në Prishtinë, 10 shkolla nuk kanë fare psikolog; në Ferizaj 19 shkolla nuk kanë as psikolog as pedagog; ndërsa në Gjakovë 35 shkolla ndajnë vetëm pesë psikologë, që nënkupton se një psikolog mbulon disa shkolla.

Gjithashtu edhe shkollat që kanë një psikologë me orar të plotë kanë numër të madh të nxënësve që bën që psikologët të kenë vështirësi në mbulimin e nevojave të gjithë nxënësve.

Në Prishtinë janë 13 shkolla me mbi 1000 nxënës dhe që kanë të angazhuar vetëm një psikolog. Ferizaj një shkollë me 800 nxënës ka dy psikologë, ndërsa shkolla tjetër gjimnaz me 700 nxënës nuk kishte asnjë psikolog të angazhuar. Ndërsa Gjakova për shkak të numrit më të ulët të nxënësve në shkolla, ka vetëm një shkollë me mbi 1000 nxënës e cila po ashtu ka të angazhuar vetëm një psikologë. Kjo ka krijuar pabarazi ndërmjet shkollave në kapacitetet që kanë për trajtimin e rasteve të dhunës, bullizmit dhe sjelljeve të përsëritura problematike.

Sipas DKA-ve, mungesa e psikologëve në një pjesë të shkollave ka ardhur si rezultat i kufizimeve buxhetore dhe interpretimit se Udhëzimi Administrativ i obligon komunat të angazhojnë psikologë vetëm në shkollat me mbi 1,000 nxënës.

Megjithatë, ky interpretim i udhëzimit administrativ nuk respektuar as nga vet komunat, pasi që në të tri komunat e audituara kishte shkolla me numër më të ulët se 1000 nxënës, mirëpo DKA-të kishin angazhuar psikologë me orar të plotë.

DKA-të dhe shkollat kanë hasur vështirësi edhe në zbatimin e mekanizmave disiplinorë dhe mbështetës për nxënësit me sjellje asociale apo të përsëritura problematike. Në veçanti, në Komunën e Prishtinës rregullorja komunale nuk parasheh transferimin e nxënësve të klasave 1-9 si masë disiplinore, ndërsa në praktikë transferimi realizohet vetëm kur prindërit japin pëlqim. Në rastet kur prindërit nuk bashkëpunojnë, shkollat mbeten me mundësi të kufizuara për menaxhimin e rasteve të përsëritura. Po ashtu, është identifikuar praktikë që psikologu shkollor të mos ofrojë shërbime për nxënësin pa pëlqimin me shkrim të prindit, edhe pse kjo praktikë nuk mbështetet drejtpërdrejt në ndonjë ndalesë ligjore. Kjo e kufizon rolin e psikologut shkollor si mekanizëm mbështetës për nxënësit që shfaqin sjellje agresive, bullizuese apo të dhunshme.

Përveç mungesës së mekanizmave të mjaftueshëm mbështetës, DKA-të nuk kanë kryer monitorim të rregullt dhe të dokumentuar të sigurisë në shkolla. Edhe pse pranojnë informacione për rastet më serioze të dhunës, asnjëra nga komunat e audituara nuk ka pasur raporte analitike apo statistika të strukturuar për dhunën dhe bullizmin në shkolla. DKA-të nuk kanë pasur ekipe apo procedura të dedikuara për monitorimin e zbatimit të Protokollit për parandalimin, trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës, nuk kanë verifikuar në mënyrë sistematike raportimet në SMIA dhe nuk kanë krahasuar të dhënat e shkollave me të dhënat e Policisë.

Gjatë auditimit është identifikuar se disa nga shkollat me numrin më të lartë të rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës nuk kishin raportuar asnjë rast në SMIA. Në pyetjet e drejtuara DKA-ve lidhur me masat e ndërmarra për këto raste, përgjigjet tregojnë se reagimi ka qenë i kufizuar dhe jo i standardizuar.

Në Prishtinë nuk është pranuar përgjigje nga DKA, ndërsa shkolla që kishte numrin më të lartë të rasteve në polici ka filluar të raportojë raste në SMIA për herë të parë pas janarit 2026 kur ka qenë duke u zhvilluar auditimit.

Në Ferizaj, DKA ka kërkuar sqarime nga shkolla me numrin më të madh të rasteve vetëm pas kërkesës tonë, ku shkolla ka dhënë sqarimet për rastet, ku shihet se rastet ishin serioze dhe përfshinin përlëshje fizike, therje me thikë dhe posedim të armëve të ftohta.

Në Gjakovë, DKA ka pranuar sqarimin e shkollës se rastet kishin ndodhur jashtë hapësirave shkollore dhe se shkolla nuk kishte të dhëna për shkak të mungesës së raporteve kthyes nga Policia.

Kjo tregon se DKA-të nuk kanë pasur kontroll të mjaftueshëm mbi mënyrën se si shkollat trajtojnë, dokumentojnë dhe raportojnë rastet e dhunës dhe incidentet që lidhen me sigurinë në shkolla.

Kjo gjendje ka ndodhur për shkak se DKA-të nuk kanë ndërtuar sistem të rregullt të monitorimit dhe mbikëqyrjes së shkollave për zbatimin e Protokollit për parandalimin, trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës. Po ashtu, nuk janë vendosur procedura të qarta për analizimin e të dhënave, verifikimin e raportimeve në SMIA, krahasimin e tyre me të dhënat e Policisë dhe ndërmarrjen e masave ndaj shkollave që nuk raportojnë apo që kanë numër të lartë të incidenteve. Në të njëjtën kohë, DKA-të nuk kanë zhvilluar mekanizma të mjaftueshëm mbështetës për rastet kur shkollat përballen me nxënës me sjellje të përsëritura problematike.

Për pasojë, DKA-të nuk kanë pasur pasqyrë të plotë dhe të besueshme mbi gjendjen reale të sigurisë në shkolla dhe nuk kanë ndërmarrë masa të mjaftueshme për adresimin e problemeve. Kjo ka ndikuar që shkollat të zhvillojnë praktika të ndryshme dhe jo të standardizuara në trajtimin dhe raportimin e rasteve të dhunës. Mungesa e mbështetjes dhe mbikëqyrjes nga DKA-të ka kufizuar aftësinë e shkollave për të menaxhuar nxënësit me sjellje të përsëritura problematike dhe ka rritur rrezikun që rastet e dhunës, bullizmit dhe sjelljeve asociale të përsëriten pa u trajtuar në mënyrë të strukturuar dhe afatgjatë.

3.8 Mungesa e masave efektive të sigurisë fizike në shkolla

DKA-të sigurojnë vendosjen dhe mirëmbajtjen e rrethojës së institucioneve edukativo-arsimore, të vendosë kamerat në institucione edukativo-arsimore, si dhe të sigurojë kushte tjera fizike që kontribuojnë në uljen e incidenteve të dhunës në shkolla²⁸. DKA-të duhet të krijojnë ambiente fizike të përshtatshme në shkolla me qëllim të garantimit të sigurisë dhe parandalimit të të gjitha formave të dhunës.

Gjatë auditimit janë realizuar vizita në 12 shkolla nga të cilat: Prishtinë 5 shkolla, Ferizaj 4 shkolla dhe Gjakovë 3 shkolla. Në lidhje me infrastrukturën fizike shihet se ka pas përmirësime, megjithatë ka dallime nga komuna në komunë.

Të gjitha shkollat posedonin kamera sigurie dhe rrethoja të oborrit, megjithatë kishin dyert të hapura dhe qasje të lehtë në shkollë për kalimtarët apo vizitorët, po ashtu shkollat posedonin numër të ulët të kamerave dhe nuk ishin të gjitha kamerat funksionale. Problematikat tjera janë mos kontrollimi i qasjes në oborr nga vizitorët, daljet e nxënësve jashtë oborrit të shkollës si dhe nuk ka kontrolle të qarta të hyrje-daljeve në shkollë.

Gjithashtu janë identifikuar probleme të pa zgjidhura pronësore të oborrit të shkollave, që ndikojnë që shkollat të mos kenë të drejtën e plotë në kontrollimin e hapësirave të tyre si institucione të pavarura.

Prishtina

Në shkollën "Ismail Qemali", edhe pse oborri i shkollës është i rrethuar, dyert e oborrit qëndrojnë të hapura dhe ekzistojnë disa qasje të tjera hyrëse përveç derës kryesore.

Sipas shpjegimeve të shkollës, mbyllja e dyerve nuk lejohet pasi oborri është në shfrytëzim të përbashkët me komunitetin dhe përdoret si zonë transiti nga qytetarët edhe pse rreth shkollës ka rrugë publike për kalimtarët dhe nuk është e domosdoshme që të përdoret oborri i shkollës si rrugë.

Kjo situatë e bën më të vështirë kontrollimin e hyrje-daljeve dhe mbikëqyrjen e nxënësve gjatë qëndrimit në oborr, duke rritur njëkohësisht rrezikun për sigurinë e tyre.

Për më tepër, në distancë shumë afër shkollës ndodhen markete dhe kioska që frekuentohen vazhdimisht nga nxënësit dhe kjo gjë rrit rrezikun që nxënësit të ekspozohen për blerje të gjësendeve të pa lejuara nga ana e nxënësve.

Foto 1-Shkolla "Ismail Qemali"- Prishtinë- Shkolla ka planimetri (sipërfaqe) prej 5700 m² dhe posedon 24 kamera sigurie.



²⁸ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, Neni 26

Nga shkollat e vizituara, Gjymnazi “Sami Frashëri” dhe “Meto Bajraktari” posedojnë dyer automatike në oborret e shkollave, duke mundësuar kontroll më të mirë të qasjes.

Ndonëse “Sami Frashëri” ka objektin të vjetërsuar. Shkolla “Sami Frashëri” me planimetri 5500 m² dhe 41 kamera sigurie.

Foto 2- Shkolla “Sami Frashëri” dhe “Meto Bajraktari”




Ndërsa “Andon Çajupi”, edhe pse ka rrethojë të oborrit, vazhdon të ketë qasje të hapur në hapësirat e oborrit të shkollës. Shkolla posedon sipërfaqe prej **4600 m²** dhe ka **16 kamera sigurie**.

Në anën tjetër, shkolla “7 Shtatori” është shkollë e ndërtuar në vitin 2025 dhe posedon infrastrukturë moderne, duke ofruar kushte dukshëm më të avancuara sa i përket organizimit dhe sigurisë fizike të hapësirave shkollore.

Kjo shkollë ka planimetri prej **1000 m²** dhe posedon **52 kamera sigurie**, njëkohësisht është shkolla me mbulueshmërinë më të madhe me kamera në komunën e Prishtinës.

Foto 3- Shkolla për hotelieri dhe turizëm – “7 shtatori” Prishtinë (shembull i mirë)



Ferizaj

Në përjashtim të shkollës “Naim Frashëri”, në shkollat tjera rrethojat ishin shumë të dobëta, madje edhe të improvizuara me materiale tjera. Shkolla “Naim Frashëri” ka hapsirë prej **2100 m²** dhe ka **12 kamera** sigurie. Ndërsa shkolla Faik Konica ka sipërfaqe prej **5700 m²** dhe ka **16 kamera** sigurie. Në shkollën “Gjon Sereçi” në Ferizaj ishte qasja e hapur në tri anë të oborrit të shkollës dhe oborri përdorej për kalim nga banorët që jetojnë në banesat afër shkollës dhe nga kalimtarët tjerë.

Në oborrin e shkollës në afërsi të fushës sportive ndodhet shpërndarësi elektrik që është komplet i pa rrethuar dhe mes oborrit të shkollës. Ndonëse është i mbyllur me dry, e ka shenjë se ka tension të lartë e cila mund të paraqesë rrezik për nxënës. Sidomos kur dihet se kjo është një shkollë që ka nivelin e nxënësve nga klasa 1-9. Shkolla posedon sipërfaqen prej **5364 m²**, ka **20 kamera** sigurie.


Foto 4- Shkolla “Gjon Sereçi”



Po ashtu oborri i gjimnazit “Kuvendi i Arbërit” përdorej si transit për të kaluar nxënësit e shkollave tjera në afërsi të kësaj shkolle, duke rritur kështu edhe më shumë mundësinë për incidente dhe konflikte mes nxënësve nga shkollat tjera dhe duke e bërë të vështirë kontrollimin e nxënësve.

Për më tepër në këtë shkollë të gjitha dyert e klasave ishin të dëmtuara dhe nuk mbylleshin. Kjo shkollë ka 4727 m² dhe ka 18 kamera sigurie.

Foto 5-“Kuvendi i Arbërit”-Ferizaj




Në të dyja rastet shkollat kishin kërkuar nga DKA mbylljen e dymve të oborrit pasi shihet si shqetësim për ta, por sipas tyre kjo ka të bëjë me çështje pronësore të pa zgjidhura dhe oborri i shkollës shfrytëzohej edhe nga komuniteti.

Në shkollat në Ferizaj sipas rasteve të policisë kishte më së shumti dëmtime të pronës dhe futje të pa autorizuar në shkollë.

Gjakovë

Në dy nga tri shkollat që kemi vizituar, oborri ishte rrethuar me muri dhe pastaj sipër murit ishin rrethojat, duke e bërë më të vështirë kalimin e rrethojave dhe futjen me forcë në oborr të shkollës. Njëra nga shkollat mbante të mbyllura dyert ("Selman Riza"), duke rritur sigurinë, dy shkollat tjera i kishin dyert të hapura. Në shkollën "Hajdar Dushi" na kanë ofruar sqarimet se kanë tentuar të mbajnë dyert e mbyllura një kohë, mirëpo sipas tyre kjo nuk kishte ndikuar mirë në sjelljet e nxënësve. Shkolla "Hajdar Dushi" ka sipërfaqe prej 6777 m² dhe posedon 45 kamera sigurie.

Foto 6- Gjimnazi "Hajdar Dushi"




Shkolla "Selman Riza" ka sipërfaqe prej 2940 m² dhe posedon 13 kamera sigurie, ndërsa shkolla "Hysni Zajmi" ka sipërfaqe prej 4191 m² dhe posedon 19 kamera sigurie.

Foto 7- "Selman Riza" dhe "Hysni Zajmi"



Ndërsa të gjitha shkollat që kemi vizituar të gjitha posedonin kamera, por mbetet ende problematikë mbulueshmëria e ulët e hapësirës shkollave me kamera, veçanërisht oborri dhe kthinat e ndryshme, gjithashtu edhe ato që janë, nuk ishin të gjitha funksionale.





Si përfundim lidhur me infrastrukturën dhe ambientin fizik të shkollave janë identifikuar çështjet si në vijim:

Sa i përket rrethojës dhe hapësirave përreth shkollave, një nga problematikat kryesore janë lokalet dhe bizneset që operojnë në afërsi të drejtpërdrejtë të shkollave. Kjo situatë bëhet edhe më problematike për shkak të frekuentimit të vazhdueshëm të këtyre lokaleve nga nxënësit gjatë pushimeve dhe qëndrimit jashtë objekteve shkollore. Kjo ndodh për shkak se në legjislacionin në fuqi nuk është përcaktuar qartë se cilat veprimtari ekonomike lejohen të ushtrohen në afërsi të shkollave dhe në çfarë distance duhet të jenë të vendosura nga institucionet arsimore. Përgjatë bëmë vetëm klubet e natës, të cilat sipas legjislacionit nuk lejohen të ushtrojnë veprimtarinë në distancë më të afërt se dy kilometra nga shkollat.

Lidhur me kamerat e sigurisë kemi analizuar dokumentacionin e pranuar nga DKA-të edhe për shkollat që **nuk** i kemi vizituar ku është identifikuar se:

Në Prishtinë të gjitha shkollat posedojnë kamera sigurie në përjashtim të disa paraleleve të ndara fizike të cilat kanë numër shumë të vogël të nxënësve.

Në Ferizaj janë dy shkolla të mëdha, nëpërmjet dokumentacionit është identifikuar se shkolla e mjekësisë me 717 nxënës dhe një gjimnaz me 928 nxënës nuk kanë ende kamera sigurie të instaluar si dhe është një shkollë më e vogël me 130 nxënës e cila po ashtu nuk ka kamera. Sipas njoftimit të DKA, në këtë gjimnaz kamerat janë instaluar në qershor të vitit 2026.

Në Gjakovë janë tetë shkolla në zona rurale që nuk kanë kamera sigurie disa janë paralele të ndara fizike me numër të vogël të nxënësve.

Ndërsa sa i përket rojës fizike apo sigurimit, vetëm në komunën e Ferizaj ishte kontraktuar ky shërbim nga komuna, kështu që shkollat e mëdha kishin nga një roje që qëndron në oborrin e shkollës. Në komunat tjera, nuk është ndërmarrë një iniciativë e tillë nga ana e komunave, vetëm se ka shkolla që me vetiniciativë dhe me vendim të Këshillit Drejtues të shkollës kanë kontraktuar roje për shkollë me vetëfinancim nga prindërit.

Shkak për këtë gjendje janë mungesa e planeve nga ana e DKA-ve, ku përcaktohet gjendja e shkollës, identifikimi i nevojave për përmirësim të infrastrukturës dhe realizimi i investimeve të nevojshme në infrastrukturën fizike të shkollave.

Kjo ka shkaktuar që infrastruktura fizike aktuale e shkollave të mos jetë në nivelin e duhur për krijimin e një ambienti sa më të sigurt për nxënësit.

3.9 Politikat e MASHTI-it nuk janë mjaftueshëm efektive për sigurinë në shkolla

MASHTI duhet që të hartojë politika dhe përcaktojë masa për të parandaluar të gjitha llojet e dhunës në shkolla, si dhe vendosë masa ndëshkimore apo disiplinore për ata që nxisin dhunë e bëjnë veprime të dhunshme në institucionet e arsimit²⁹.

Në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (në vijim: MASHTI), përmes “Strategjisë së Arsimit 2022-2026” ishte vendosur objektivi për krijimin e mjediseve shkollore të shëndetshme ku ishte paraparë zhvillimi i disa aktiviteteve me qëllim që të zbatohen masat për parandalimin dhe raportimin e dhunës në shkolla. Në kuadër të këtij objektivi, në vitin 2022 është themeluar forumi ndërinstitutional “Shkolla miqësore - Rritemi së bashku”, ndërsa në fund të vitit 2023 është hartuar Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve me qëllim të mbështetjes së zbatimit të Rregullores për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Shkolla.

MASHTI ka ndërmarrë disa iniciativa, si: sesione informuese, materiale promovuese, manuale dhe udhëzues për të drejtat e fëmijëve dhe sigurinë në internet, me qëllim sensibilizimin e mësimitdhënësve, nxënësve dhe prindërve. Gjithashtu, në bashkëpunim me OJQ-të partnere, gjatë vitit 2024 dhe 2025 janë zhvilluar takime dhe sesione informuese nëpër komuna me DKA-të dhe drejtorët e shkollave për promovimin dhe zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve. Si dhe është ndërmarrë iniciativë për përfshirjen e orës së kujdestarisë si masë parandaluese. Detajet në shtojca 2.

Megjithatë, gjatë auditimit janë identifikuar disa zbrazëtira në hartimin e politikave dhe harmonizimin e akteve nënligjore në lidhje me sigurinë në shkolla të cilat janë shpjeguar më në detaje në vijim:

Rregullorja për Protokollin nuk përbën obligim për drejtorët e shkollave për raportimin e rasteve të dhunës në sistemin SMIA. Kjo ndërlidhet me faktin se në kohën kur është aprovuar rregullorja, në vitin 2013, nuk ekzistonte moduli në SMIA për raportimin e incidenteve të dhunës. Ky modul ishte shtuar në vitin 2015, por krahas saj nuk ishte përditësuar edhe rregullorja për protokollin. Prandaj, këto dy dokumente kanë mbetur të pa harmonizuara, sepse rregullorja kërkon që drejtori i shkollës të evidentojë të gjitha rastet e dhunës në regjistrin fizik përkatës dhe t’i dorëzojë këto të dhëna në DKA dy herë në vit, përderisa udhëzuesi kërkon që drejtori i shkollës të raportojë menjëherë, në mënyrë elektronike, përmes sistemit SMIA e cila ka zëvendësuar raportimin përmes regjistrave fizikë. Sipas MASHTI, kjo situatë ka ndodhur për shkak se Rregullorja për Protokollin është akt i aprovuar nga Qeveria, ndërsa ministria nuk kishte iniciuar ndryshimin dhe përditësimin e saj pas hyrjes në funksion të raportimit në SMIA në vitin 2015.

MASHTI nuk ka realizuar ndonjë analizë të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirëse lidhur me situatën e sigurisë në shkolla. Përveç disa hulumtimeve dhe anketimeve me nxënës, prindër dhe mësimitdhënës, kryesisht të realizuara nga organizata joqeveritare, nuk ka pasur një vlerësim të strukturuar institucional mbi këtë çështje. Një hulumtim ishte realizuar në vitin 2022 me

²⁹ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, Neni 7

mbështetjen e OSBE-së, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës. Megjithatë, këto iniciativa nuk kanë ndihmuar në krijimin e mekanizmave për identifikimin e problematikave kryesore dhe planifikimin e masave konkrete për rritjen e sigurisë në shkolla.

MASHTI nuk ka koordinator apo strukturë të dedikuar dhe që është përgjegjës për sigurinë në shkolla. Në të kuluaren me koordinimin e proceseve për sigurinë në shkolla ishte marrë zyrta për të drejtat e njeriut, funksion ky i cili i takon një domeni më të gjerë dhe nuk adreson ndërtimin e mekanizmave që rrisin sigurinë në shkolla dhe që kontribuojnë për parandalimin dhe trajtimin e dhunës dhe dukurive tjera negative në shkolla.

MASHTI nuk ka monitoruar zbatimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve që ka ndikuar që shkollat të aplikojnë praktika të ndryshme dhe jo të standardizuara. Sipas Ministrisë me këtë proces janë angazhuar OJQ-të në kuadër të marrëveshjeve bashkëpunuese sepse Ministria nuk ka resurse për të monitoruar zbatimin e saj.

Kjo gjendje ka ndodhur për shkak se MASHTI nuk ka siguruar një qasje të koordinuar institucionale për menaxhimin e sigurisë në shkolla. Në veçanti, nuk ka zhvilluar analiza të rregullta dhe gjithëpërfshirëse të gjendjes, nuk ka caktuar një strukturë apo koordinator përgjegjës, nuk ka vendosur mekanizma për monitorimin e politikave ekzistuese dhe nuk e ka përditësuar Rregulloren për Protokollin pas funksionalizimit të modulit të raportimit në SMIA.

Për pasojë, MASHTI nuk ka miratuar një strategji kombëtare për sigurinë në shkolla, e cila do të përcaktonte objektivat, përgjegjësitë dhe veprimet e koordinuara institucionale. Mungesa e saj ka bërë që siguria në shkolla të trajtohet përmes iniciativave të veçanta, duke kufizuar efektivitetin e masave për parandalimin dhe trajtimin e dhunës, bullizmit dhe sjelljeve asociale të nxënësit.

3.10 Inspektorati i Arsimit nuk bën mbikëqyrjen e sigurisë në shkolla

MASHTI duhet të mbikëqyrë përmes inspektimit funksionimin e sistemit arsimor, duke siguruar zbatimin e gjitha masave dhe veprimeve të parapara, përfshirë edhe ato masa që sanksionojnë dhunën në shkolla³⁰.

Inspektorati i arsimit duhet të kontrollojë veprimtarinë e institucioneve arsimore si dhe raporton lidhur me këtë veprimtari tek Ministria e Arsimit, DKA-të dhe institucionet tjera përgjegjëse³¹. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i Inspektoratit të Arsimit rregullohet me akt nënligjor sipas detyrave dhe funksioneve të këtij organi.³²

Inspektorati i arsimit si institucioni mbikëqyrës i gjitha institucioneve arsimore në nivel qendror, mbulon të gjitha nivelet e arsimit, që nga arsimi para-fillor e deri te arsimi universitar.

Gjatë auditimit është identifikuar se Inspektorati i Arsimit nuk ka realizuar inspektime të dedikuara për sigurinë në shkolla dhe për zbatimin e Rregullore për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës. Edhe pse kjo rregullore kërkon që Inspektorati të monitorojë, mbikëqyrë, inspektojë dhe vlerësojë zbatimin e saj, një gjë e tillë nuk është realizuar asnjëherë. Për më tepër, Ligji për Inspektoratin e Arsimit, i miratuar në vitin 2018 nuk parasheh në mënyrë të veçantë inspektime për sigurinë në shkolla.

Në planet vjetore të punës së Inspektoratit për periudhën 2022–2025 nuk ishin planifikuar inspektime të dedikuara për sigurinë në shkolla. Planet përfshinin kryesisht inspektime administrative, pedagogjike dhe tematike, si dhe trajtim të ankesave të nxënësve, prindërve apo mësimitdhënësve. Sipas Inspektoratit, elemente të sigurisë trajtohen brenda këtyre llojeve të inspektimeve. Megjithatë, nga analizimi i raporteve dhe procesverbaleve rezulton se këto inspektime nuk kanë trajtuar në mënyrë përmbajtësore zbatimin e protokollit, mënyrën e trajtimit të rasteve të dhunës, raportimin në SMIA, funksionimin e mekanizmave shkollorë për parandalim, apo masat e ndërmarra për adresimin e dhunës dhe bullizmit.

Në inspektimet administrative, çështja e sigurisë përmendet vetëm në mënyrë të përgjithshme, kryesisht përmes deklarimeve të drejtorëve të shkollave dhe jo përmes verifikimit të dokumentacionit, evidencave apo rasteve konkrete. Inspektimet tematike lidhen kryesisht me ankesa individuale, ndërsa vlerësimi i jashtëm realizohet mbi bazën e vetëvlerësimit të shkollës dhe nuk përbën kontroll të drejtpërdrejtë mbi zbatimin e protokollit për dhunën në shkolla. Si rezultat, deri më tani nuk është kryer asnjë inspektim që vlerëson në mënyrë të plotë nëse shkollat i identifikojnë, trajtojnë, raportojnë dhe përcjellin rastet e dhunës sipas kërkesave të rregullore.

Gjithashtu, Inspektorati i Arsimit nuk ka profilizuar inspektorët sipas niveleve të arsimit apo sipas llojit të inspektimeve. Aktualisht, i njëjti inspektor mund të angazhohet në inspektime të ndryshme dhe në nivele të ndryshme të arsimit, pavarësisht natyrës specifike të çështjeve që trajtohen. Kjo ka ndodhur për shkak se Inspektorati nuk kishte miratuar rregulloren e brendshme për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, siç kërkohej pas miratimit të Ligjit për Inspektoratin e

³⁰ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, Neni 7 (Gjitha kriteret për MASHTI)

³¹ Ligji nr 06/L 046 për Inspektoratin e Arsimit

³² Ligji nr 06/L 046 për Inspektoratin e Arsimit, neni 6

Arsimit. Si pasojë, nuk janë përcaktuar qartë rolet, përgjegjësitë dhe specializimet e inspektorëve. Sipas Inspektoratit, rregullorja e brendshme është në proces të miratimit dhe parasheh profilizimin e inspektorëve.

Përveç mungesës së profilizimit, inspektoratit i arsimit kishin pasur edhe mungesa të resurseve njerëzore, ndërsa deri në qershor 2025 kishte qenë me u.d. të Drejtorit të Inspektoratit të Arsimit. Tabela në vijim paraqit numrin e inspektorëve dhe pozitat e tyre.

Tabela 17- Staf i inspektoratit të arsimit³³

Pozitat	2022	2023	2024	2025
Drejtor	1	1	1	1
Udhëheqës sektori	7	6	6	6
Inspektorë	25	24	23	43
Gjithsej në vitin përkatës	33	31	30	50

Kjo gjendje ka ndodhur për shkak të mungesës së harmonizimit ndërmjet Rregullores për Protokollin dhe Ligjit për Inspektoratin e Arsimit, mungesës së planifikimit të inspektimeve të dedikuara për sigurinë në shkolla, si dhe mungesës së organizimit të brendshëm dhe profilizimit të inspektorëve për fusha specifike të mbikëqyrjes.

Për pasojë, shkollat nuk janë mbikëqyrur në mënyrë efektive për zbatimin e protokollit, trajtimin e rasteve të dhunës dhe raportimin e tyre. Kjo ka ndikuar që qasja ndaj dhunës në shkolla të mbetet kryesisht në nivel të praktikave individuale të shkollave, pa kontroll të mjaftueshëm institucional dhe pa llogaridhënie të qartë për mënyrën se si shkollat parandalojnë, trajtojnë dhe raportojnë rastet e dhunës.

³³ Në vitin 2024 janë pensionuar 3 inspektorë, Në vitin 2025 është pensionuar një inspektor dhe kanë pranuar në punë gjithsej 22 inspektor të rinj.

4. Konkluzionet

Institucionet përgjegjëse kanë vendosur disa mekanizma dhe kanë ndërmarrë iniciativa për sigurinë në shkolla, megjithatë këto nuk funksionojnë si një sistem i koordinuar, i standardizuar dhe efektiv për parandalimin, trajtimin, raportimin dhe monitorimin e dhunës. Shkollat kryesisht reagojnë pas incidenteve, ndërsa masat parandaluese, trajtimi i rasteve dhe raportimi në SMIA nuk zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme. Mungesa e të dhënave të sakta dhe analizave të mirëfillta ka kufizuar MASHTI-t, DKA-ve dhe Inspektoratit të Arsimit për të vlerësuar gjendjen reale të sigurisë dhe për të ndërmarrë masa të bazuara në rrezik. Si rezultat, nxënësit nuk përfitojnë gjithmonë mbrojtje, trajtim dhe mbështetje të duhur institucionale, ndërsa sistemi arsimor nuk ka siguri të mjaftueshme se rastet e dhunës dhe bullizmit parandalohen, trajtohen dhe përcillen deri në zgjidhje.

Rezultatet e pyetësorit të realizuar me 771 nxënës në tri komuna tregojnë se vetëm 52% e nxënësve e shohin shkollën e tyre si vend të sigurt, 39% e shohin shkollën si pjesërisht e sigurt, ndërsa 9% e nxënësve të përgjigjur në pyetësor ndihen se shkolla e tyre është vend i pasigurt. Gjithashtu është e lartë përqindja e nxënësve që kanë qenë viktimë apo dhunë e bullizmit, ku 33% e tyre janë shprehur se kanë përjetuar dhunë apo bullizim në shkollë përderisa 13% e nxënësve kanë preferuar të mos japin përgjigje lidhur me këtë pyetje. Gjithashtu edhe liria për të raportuar rastet është paraqitur si shqetësim tjetër nga nxënësit ku 15% e nxënësve nuk ndiejnë liri të raportojnë. Nxënësit kanë shprehur shqetësime dhe kërkesa lidhur me sigurinë në shkolla, duke kërkuar: kontrolle më të shpeshta ndaj nxënësve, vendosje të kamerave të sigurisë, roje fizike, masa më të rrepta disiplinore, përjashtim i nxënësve problematikë nga shkolla, organizim të ligjëratave vetëdijësuese si dhe prani më të shtuar të policisë në shkolla.

Trajtimi i rasteve të dhunës në shkolla nuk është i standardizuar dhe mbetet kryesisht reagues, duke u fokusuar në adresimin e incidenteve pasi ato kanë ndodhur, në vend se në menaxhimin e plotë dhe parandalimin e tyre. Praktikrat e shkollave fokusohen në shqiptimin i masave disiplinore dhe zhvillimin e bisedave me nxënësit dhe prindërit, ndërsa mungojnë elementet kyçe të menaxhimit të rasteve, si: caktimi i menaxherit të rastit, hartimi i planeve të mbrojtjes dhe monitorimi sistematik i progresit të rasteve. Po ashtu, dokumentimi i rasteve nuk është i plotë dhe i strukturuar, pasi kryesisht regjistrohen vetëm incidentet më serioze. Si rezultat, rastet e bullizmit, dhunës psikologjike dhe sjelljeve problematike të nxënësve shpesh mbeten të paidentifikuara ose nuk trajtohen në mënyrë adekuate dhe të vazhdueshme. Për më tepër, shkollat nuk zhvillojnë qasje efektive që krahas trajtimit të incidenteve, të sigurojnë masa afatgjata për parandalimin e dhunës, rehabilitimin e nxënësve të përfshirë në konflikte dhe mbështetjen e viktimave.

Të dhënat e raportuara nga shkollat mbi incidentet e dhunës në shkolla nuk janë të sakta, të plota dhe të besueshme, duke pamundësuar krijimin e një pasqyre reale për shkollën e dhunës dhe bullizmit në nivel vendi. Sistemi i raportimit nuk përdoret në mënyrë efektive nga shkollat, pasi vetëm rreth 2% e tyre kanë raportuar incidente në SMIA, ku numri i rasteve të raportuara gjatë një viti arrin deri në 45 raste për të gjithë Kosovën. Ka një mos përputhje të lartë mes të dhënave të raportuara nga shkollat dhe nga raportet e policisë, kur të dhënat e policisë për incidentet e dhunës

sillen nga 550 deri në 600 raste në vit. Kjo tregon se një pjesë e madhe e rasteve të dhunës në shkolla nuk regjistrohen ose nuk raportohen përmes mekanizmave të paraparë në sistemin arsimor.

Qendrat për Punë Sociale nuk kanë evidenca të plota dhe mekanizma funksionale për pranimin, regjistrimin, trajtimin dhe përcjelljen e rasteve të referuara nga shkollat. Rastet e referuara nga shkollat nuk janë çdo herë të evidentuara në regjistrat e QPS, ka mungesa të raporteve kthyesë, koordinimit ndërinstitutional, stafit të specializuar dhe monitorimit të punës. Në asnjërën nga qendrat nuk është punësuar zyrtari i dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve sikurse kërkohet me ligj. Rastet e referuara nga shkollat në QPS nuk janë trajtuar me kohë dhe qendrat për punë sociale nuk kanë dërguar raportet apo informatat kthyesë të shkollat mbi rastet e referuara.

Drejtoritë Komunale të Arsimit nuk kanë ushtruar në mënyrë efektive rolin e tyre të monitorimit dhe mbikëqyrjes së shkollave lidhur me parandalimin, trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës. DKA-të nuk kanë kontrolluar as shkollat të cilat përkundër numrit të lartë të rasteve të paraqitura në raportet e policisë kanë pasur zero raportime në sistemin SMIA. Po ashtu, DKA-të nuk kanë arritur të sigurojnë mekanizmat e nevojshëm për të mbështetur shkollat në menaxhimin e incidenteve të dhunës. Në disa raste janë evidentuar mangësi edhe në masat bazike të sigurisë, siç është mungesa e kamerave të sigurisë në shkolla me nivel të lartë incidentesh. Për më tepër, praktika e ndjekur në Komunën e Prishtinës, ku shërbimet psikologjike ofrohen vetëm me pëlqimin paraprak të prindërve, kufizon mundësinë e ndërhyrjes së hershme dhe zvogëlon efektivitetin e trajtimit të nxënësve me sjellje problematike. Gjithashtu, DKA-të nuk kanë hartuar dhe zbatuar as plane strategjike dhe politika efektive për të rritur sigurinë në shkolla.

DKA-të nuk kanë ndërmarrë masa të dukshme as sa i përket përmirësimit të kushteve dhe infrastrukturës fizike në shkolla. Qasja në hyrje të oborreve nuk është e kontrolluar, duke mundësuar hyrjen e personave të paautorizuar në hapësirat shkollore. Në tri shkolla të vizituara, oborri i shkollës përdorej si transit për kalimtarë dhe komunitetin, duke vështirësuar menaxhimin e sigurisë dhe kontrollin e nxënësve. Kamerate e sigurisë të vendosura në shkolla kishin mbulueshmëri të ulët dhe në disa raste kamerat nuk ishin funksionale. Gjitha këto mangësi në infrastrukturën fizike kanë ndikuar që shkollat të mos arrijnë të krijojnë ambiente të përshtatshme që rrisin sigurinë e nxënësve dhe që ndikojnë në mbrojtjen e interesit të fëmijëve.

Inspektorati i Arsimit deri më tani nuk ka realizuar asnjëherë inspektime lidhur me sigurinë në shkolla. Pra nuk është mbikëqyrur asnjëherë nëse shkollat kanë zbatuar rregulloren për protokollin për parandalimin, trajtimin dhe referimin e dhunës në shkolla. Aktivitetet dhe inspektimet e realizuara kanë trajtuar vetëm pjesërisht elemente të sigurisë, pa vlerësuar në mënyrë konkrete trajtimin e rasteve të dhunës, raportimin, transparencën, funksionimin e mekanizmave mbrojtës dhe kushtet e sigurisë në shkolla. Për më tepër inspektorati nuk kishte pas asnjëherë në planin e punës inspektimin e sigurisë në shkolla. Gjithashtu nuk ishte bërë as profilizimi i inspektorëve. Po ashtu, MASHTI nuk ka bërë analizë lidhur me gjendjen e sigurisë në shkolla, duke bërë që institucionet të mos kenë vlerësim të qartë të rreziqeve, problematikave dhe nevojave reale për planifikimin e masave efektive parandaluese dhe mbrojtëse.

5. Rekomandimet

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

1. Të hartojë politika apo strategji për sigurinë në shkolla të cilat janë të zbatueshme dhe harmonizuar, si dhe të vendosen mekanizma funksional që mundësojnë: parandalimin, trajtimin, dokumentimin dhe raportimin sistematik dhe transparent të rasteve të dhunës dhe bullizmit.
2. Të profilizojë inspektorët e arsimit si dhe të monitorojë, mbikëqyrë dhe inspektojë zbatimin e politikave mbi parandalimin, trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës në shkolla dhe të forcojë llogaridhënien.
3. Të përcaktojë qartë veprimet, hapat dhe procedurat që institucionet e arsimit parauniversitar duhet të ndjekin para referimit të rasteve në institucionet tjera përgjegjëse dhe palëve të përfshira sikurse janë: qendra për punë sociale, policia e Kosovës etj. Të definojnë edhe procedurat që ndiqen pas referimit të rasteve nga gjitha palët e përfshira, me qëllim që të definojë veprimet e secilit institucion.
4. Të përcaktojë qartë shkallët (kategoritë) e rasteve të dhunës dhe bullizmit që duhet të raportohen nga institucionet e arsimit parauniversitar me qëllim të standardizimit të raportimit dhe sigurimit të të dhënave të plota dhe të krahasueshme në nivel nacional.
5. Të realizojë së paku një herë në vit pyetësor online me nxënës në nivel kombëtar, me qëllim të vlerësimit të nevojave dhe shqetësimeve të tyre, identifikimit të problematikave në shkolla dhe planifikimit të masave dhe zgjidhjeve adekuate për përmirësimin e sigurisë dhe mirëqenies së nxënësve.

Policia e Kosovës

1. Të forcojë bashkëpunimin me MASHTI-n dhe institucionet tjera relevante, të definojë mënyrën e shkëmbimit të informatave relevante me shkollat për rastet ku përfshihen nxënësit, duke respektuar interesin më të mirë të fëmijës dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Komunat: Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë

1. Të hartojnë strategji dhe plane veprimi të zbatueshme për sigurinë në shkolla si dhe të zhvillojë mekanizma monitorimi lidhur me: parandalimin, trajtimin, referimin dhe raportimin e rasteve të dhunës në shkolla.
2. Të vlerësojnë rreziqet që lidhen me infrastrukturën fizike të shkollave dhe të sigurojnë masa të përshtatshme për kontrollin e qasjes, funksionalitetin e kamerave dhe mbikëqyrjen e hapësirave me rrezik më të lartë, duke respektuar privatësinë e nxënësve.
3. Të zhvillohen programe dhe aktivitete me këshillin e prindërve të komunës dhe të shkollave me qëllim të sensibilizimit dhe rritjes së bashkëpunimit.

Komuna e Prishtinës

1. Të rishikohen mekanizmat disiplinorë dhe rehabilitues për nivelin e shkollave të mesme të ulëta (klasat 6-9) , me fokus në trajtimin e nxënësve me sjellje të vazhdueshme asociale.
2. Të sigurohet se Qendra për Punë Sociale trajton dhe shqyrton të gjitha rastet e referuara nga shkollat, si dhe të sigurojë kthimin e përgjigjeve brenda afateve kohore të përcaktuara në rregullore, edhe në rastet kur vlerëson se rasti nuk bie në kompetencën e trajtimit të saj.
3. Të vendosë në Qendrat për Punë Sociale një kanal të dedikuar komunikimi për shkollat, përmes të cilit të pranohen, evidentohen dhe trajtohen në mënyrë të strukturuar të gjitha referimet dhe kërkesat që lidhen me rastet e nxënësve dhe çështjet e sigurisë në shkolla. Ky kanal duhet të jetë i qartë dhe i njohur për të gjitha institucionet arsimore, në mënyrë që shkollat të kenë një pikë të vetme kontakti për raportimin dhe referimin e rasteve që kërkojnë ndërhyrje nga Qendrat për Punë Sociale.

Shtojca 1. Motivi i auditimit, kriteret, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Problemi i auditimit dhe materialiteti

Siguria e nxënësve në shkolla është një parakusht themelor për procesin arsimor cilësor dhe për mirëqenien fizike, emocionale dhe psikologjike të të rinjve. Prandaj kjo temë përmban materialitet të lartë për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë që ka në të gjitha aspektet jetësore të fëmijëve dhe shoqërisë si tërësi në Kosovë.

Materialiteti për sigurinë në shkolla është i ndarë në dy aspekte:

1. **Kualitativ**- ka ndikim në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve, të drejtat e fëmijëve etj.
2. **Kuantitativ**- ka numër të lartë të incidenteve por edhe ka kosto të resurseve për menaxhimin e tyre.

Në Kosovë janë evidentuar shqetësime të vazhdueshme që lidhen me sigurinë në shkollat publike. Disa nga këto shqetësime lidhen me çështjet e paraqitura si më poshtë:

Shkollat nuk regjistrojnë/ raportojnë dhe trajtojnë si duhet incidentet e dhunës	Mungesë e stafit mbështetës sikurse janë: psikologët dhe pedagogët	Incidentet mes nxënësve janë në rritje, si dhe përfshirja e tyre në substanca të dëmshme	Mungesë e infrastrukturës fizike: kamera, rojet, rrethojat, uniformat.	Mungesa e Planeve të veprimit nga drejtoritë e arsimit
---	---	---	---	---

Protokolli për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar nuk është duke u zbatuar plotësisht.

Numri i rasteve të dhunës të raportuara në SMIA, është shumë i vogël ku në vitin shkollor 2023/24 janë raportuar vetëm 48 raste³⁴. Ndërsa, në Policinë e Kosovës gjatë vitit 2024 janë raportuar gjithsej 429 raste të incidenteve në shkolla dhe përreth tyre (në diametër shumë të afërt të institucioneve shkollore)³⁵. Kjo për arsye se shkollat nuk raportojnë rastet në SMIA. Mungesa e sigurisë në shkolla, veçanërisht dhuna në shkolla paraqet një problem real dhe në rritje, që prek mirëqenien psikologjike dhe fizike të nxënësve. Sipas një raporti të Avokatit të Popullit të vitit 2024, afërsisht 77% e nxënësve nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë kanë përjetuar ndonjë formë dhune duke përfshirë dhunë: verbale, psikologjike, fizike e të tjera³⁶. Sipas këtij raporti nga 12,000 nxënës të anketuar nga klasa 6-9, rezultati është që 77% e tyre janë deklaruar se kanë përjetuar ndonjë formë dhune.

Po ashtu në kuadër të raportit theksohet edhe:

- mungesa e trajtimit të duhur të incidenteve të dhunës nga ana e institucioneve të arsimit, më konkretisht menaxhmenti dhe personeli i shkollave.
- mungesa e trajnimeve, ku nga 139 mësimdhënës të anketuar, vetëm 37% e tyre janë deklaruar se kanë ndjekur trajnime lidhur me dhunën dhe sigurinë në shkolla.

³⁴ MASHTI, email dt 09 tetor 2025

³⁵ Policia e Kosovës, email dt 24 tetor 2025

³⁶ Raporti Vjetor 2024, Avkati i Popullit

- nga fokus grupet e organizuara me prindër dhe mësimdhënës ishin ngritur shqetësimet për eskalim të incidenteve të dhunës për shkak që mësimdhënësit apo personeli i shkollës nuk kanë reaguar me kohë dhe nuk kanë trajtuar rastet si duhet³⁷.

Shqetësime lidhur me sigurinë në shkolla janë ngritur edhe nga mediet dhe shoqëria civile. Në një konferencë të mbajtur në vitin 2024 nga KOMF (Koalicioni i OJQ-ve për mbrojtjen e fëmijëve) kishte theksuar se shkollat në Kosovë kanë probleme të theksuara në raport me dhunën në shkolla dhe atë për disa arsye:

- shkollat kanë mjedis të pasigurtë dhe jo miqësor,
- infrastruktura e papërshtatshme,
- qasje jo e duhur e mësimdhënësve,
- mungesë e personelit profesional pedagogjik dhe psikologjik në shkolla,
- mungesë e bashkëpunimit të mirëfilltë me prindër, etj³⁸.

Gjithashtu një dukuri tjetër shqetësuese është edhe mbajtja e armëve në shkolla nga nxënësit, nga mediat janë raportuar disa raste ku në shkolla të ndryshme janë gjetur nxënës të armatosur.³⁹

Prandaj gjitha indikacionet e listuara më sipër tregojnë se siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë është në nivel të ulët dhe përbën shqetësim të vazhdueshëm. Mos zbatimi i plotë i protokolleve për parandalimin dhe referimin e dhunës, raportimi i pamjaftueshëm i rasteve në SMIA krahasuar me të dhënat e Policisë, si dhe mungesa e stafit profesional mbështetës dhe të trajnuar në mënyrë që të trajtojnë si duhet incidentet e dhunës në shkolla, dëshmojnë për menaxhim joefikas të sigurisë në shkolla.

Kriteret e auditimit

1. Për të vlerësuar se: A kanë krijuar institucionet përgjegjëse mekanizma efektivë për parandalimin dhe trajtimin e incidenteve në shkolla, kemi përcaktuar kriteret si më poshtë:

MASHTI duhet që të hartojë politika dhe përcaktojë masa për të parandaluar të gjitha llojet e dhunës në shkolla, si dhe vendosë masa ndëshkimore apo disiplinore për ata që nxisin dhunë e bëjnë veprime të dhunshme në institucionet e arsimit.

MASHTI duhet të mbikëqyrë përmes inspektimit funksionimin e sistemit arsimor, duke siguruar zbatimin e gjitha masave dhe veprimeve të parapara, përfshirë edhe ato masa që sanksionojnë dhunën në shkolla.

MASHTI duhet të ofrojë përmbajtje dhe plan-programe që lidhen me çështjet e sigurisë dhe parandalimin e dhunës si dhe të vlerësojë në mënyrë të rregullt të dhënat dhe shkallën e paraqitjes së dhunës në institucionet e arsimit para-universitar për të ndërmarrë masat që janë të përshtatshme dhe efektive për parandalimin dhe trajtimin e dhunës⁴⁰.

DKA-të duhet të krijojnë ambiente fizike të përshtatshme në shkolla me qëllim të garantimit të sigurisë dhe parandalimit të të gjitha formave të dhunës.

³⁷ Raporti i akovatatit të popullit 2024, fq 17-22

³⁸ [Arsimi në rënie të lirë! - Komf Kosova](#)

³⁹ <https://sinjali.com/shqetesuese-nxenesit-ne-shkolla-me-arme-dy-16-vjecare-ne-suhareke-kapen-ne-flagrance/> <https://insajderi.org/la/nxenesit-e-vushtrise-me-arme-ne-shkolle/> <https://insajderi.com/perleshje-me-arme-mes-nxenesve-ne-mitrovice/> <https://klankosova.tv/shqetesim-ne-shkollen-e-ferizajt-13-vjecari-me-arme-zjarri-ne-shkolle1/>

⁴⁰ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, Neni 7 (Gjitha kriteret për MASHTI)

DKA-të duhet të koordinojnë punën me Shkollat, Këshillin e Prindërve, me Këshillin e Nxënësve dhe me organizatat vendore dhe ndërkombëtare në adresimin e dhunës në shkolla.

DKA-të duhet të miratojnë rregulloret e institucioneve arsimore dhe monitorojnë zbatimin e tyre. DKA-të bashkëpunojnë me Policinë, Këshillin Komunal për Siguri, Qendrën për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, me partnerë të tjerë dhe komunitetin, duke krijuar siguri brenda dhe përreth institucioneve arsimore.

DKA-të sigurojnë vendosjen dhe mirëmbajtjen e rrethojës së institucioneve edukativo-arsimore, të vendosë kamerat në institucione edukativo-arsimore, si dhe të sigurojë kushte tjera fizike që kontribuojnë në uljen e incidenteve të dhunës në shkolla⁴¹.

Komunat duhet të bëjnë përgatitjen, miratimin dhe implementimin e Rregullores së Punës për shkollat, duke përfshirë Kodin e Mirësjelljes për stafin menaxherial, mësimdhënësit, personelin tjetër dhe nxënësit, të vendosin masat disiplinore si dhe duhet të trajtojnë personelin e shkollave⁴². Drejtori i institucionit të arsimit parauniversitar cakton menaxherin/përgjegjësin e rastit, që do të jetë përgjegjës të përcjellë rastin deri në mbyllje, ndërsa me trajtimin e vet rastit merren ekipet profesionale adekuate⁴³.

IAP, më konkretisht drejtori i institucionit të arsimit parauniversitar duhet të shqyrtojë menjëherë të gjitha rastet e dhunës të paraqitura në shkolla dhe atë duke pasur parasysh çdo herë interesin më të lartë të fëmijës⁴⁴.

IAP duhet të referojë rastin në Polici pa deklaram paraprak të palëve në rastet kur ekziston dyshim i arsyeshëm se fëmija është viktimë apo dëshmitar i veprës penale, kur është në interesin më të lartë të fëmijës dhe kur intensiteti i dhunës dhe nevoja për ndërhyrjen e Policisë së Kosovës është e domosdoshme. Polici që merret me rastin duhet të veprojë menjëherë në përputhje me procedurat e parapara⁴⁵.

Institucioni i arsimit para-universitar duhet të referojë rastin e dhunës në Qendër për Punë Sociale kur kanë informacionin se një fëmijë ka nevojë për mbrojtje dhe trajtim nga shërbimet profesionale⁴⁶.

2. Për të vlerësuar se: A janë efektive institucionet përgjegjëse në procesin e raportimit dhe monitorimit të incidenteve që ndodhin në shkolla publike, kemi vendosur kriteret si në vijim:

Institucioni i Arsimit (IA) parauniversitar ka për detyrë përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit (SMIA) dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës⁴⁷.

IA parauniversitar duhet të ketë sistem të mbajtjes së evidencave fizike të rasteve që ndodhin në terren.

⁴¹ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, Neni 8 (Gjitha kriteret për DKA)

⁴² Ligji Nr 03/L-068 Për Arsimin në Komunitet dhe Republikës së Kosovës

⁴³ Poaty

⁴⁴ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, Neni 21

⁴⁵ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, Neni 22

⁴⁶ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, Neni 23

⁴⁷ Ligji 04 L 032, Ligji për arsimin parauniversitar, Neni 20

Drejtori i institucionit të arsimit parauniversitar është obliguar të sigurojë, ruajë dhe të analizojë të dhënat mbi dhunën e paraqitur në institucionin që drejton, në mënyrën më të mirë të mundshme. Nuk lejohet në asnjë formë modifikimi i regjistrit të rasteve në shkolla si dhe formës së raportimit përmbledhës për DKA⁴⁸.

Drejtori i institucionit të arsimit parauniversitar është përgjegjës për raportimin e të dhënave statistikore për rastet e dhunës bazuar në regjistrin e rasteve përkatëse raporton në DKA, ky raportim bëhet dy herë në vit. Gjithashtu edhe raportimi në MASHTI bëhet dy herë në vit.


Inspektorati i arsimit duhet të kontrollojë veprimtarinë e insitucioneve arsimore si dhe raporton lidhur me këtë veprimtari tek Ministria e Arsimit, DKA-të dhe institucionet tjera përgjegjëse.

Inspektorati i arsimit duhet të planifikojë dhe realizojë inspektime tematike duke u bazuar në kërkesat të palëve të treta apo në planin vjetor të inspektoratit.

Përshkrimi i sistemit dhe akterëve tjerë relevant

Lidhur me sigurinë e nxënësve në Shkolla janë të përfshira disa institucione, niveli i përfshirjes së tyre bëhet varësisht nga roli që kanë dhe detyrat që ushtrojnë.

Grafiku në vijim paraqet institucionet dhe rolet e secilit prej tyre.



Sikurse shihet nga grafiku i paraqitur Ministria e Arsimit luan rolin kryesor në vendosjen dhe hartimin e politikave dhe strategjive. Akterët tjerë si: Inspeksioni i Arsimit, Drejtoria Komunale dhe Shkollat i raportojnë Ministrisë së Arsimit.

⁴⁸ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, Neni 25

Ndërsa Policia e Kosovës ka përfshirje të lartë sa i përket sigurisë në shkolla, po ashtu dhe Qendrat për Punë Sociale janë Institucione të veçanta që veprojnë në kuadër të drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në komunat përkatëse por të cilat funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë përfshirje të lartë për sa i përket sigurisë në shkolla. Në vijim kemi paraqitur rolin dhe detyrat për secilën prej këtyre institucioneve veç e veç.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

MASHTI është institucioni përgjegjës në nivel qendror për hartimin dhe zbatimin e politikave arsimore, përfshirë politikat për mbrojtjen e fëmijëve dhe sigurimin e një mjedisi të sigurt arsimor. Detyrat kryesore të Ministrisë janë si në vijim:

- Hartimin e politikave dhe udhëzimeve administrative për mbrojtjen e fëmijëve në institucionet arsimore.
- Monitorimin e zbatimit të këtyre politikave përmes Inspektoratit të Arsimit.
- Bashkëpunimin me institucione të tjera qendrore dhe lokale për adresimin e rasteve të dhunës, neglizhencës dhe abuzimit ndaj fëmijëve.
- Mbështetjen e DKA-ve dhe shkollave në ngritjen e kapaciteteve për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve.

Inspektorati i Arsimit

Inspektorati vepron në kuadër të MASHTI-t dhe ka mandat për të monitoruar zbatimin e politikave arsimore dhe standardeve të sigurisë në institucionet shkollore. Detyrat kryesore të IA janë:

- Kryerja e inspektimeve tematike dhe të rregullta për të vlerësuar zbatimin e masave të sigurisë.
- Raportimi tek MASHTI për gjetjet, mospërputhjet dhe rekomandimet për përmirësim.
- Mbikëqyrja e zbatimit të udhëzimeve

Policia e Kosovës (PK)

Policia është institucioni përgjegjës për reagimin dhe hetimin e rasteve të dhunës, abuzimit apo veprave penale që ndodhin brenda ose në afërsi të institucioneve arsimore. Roli i saj përfshin:

- Ndërhyrjen në rastet e raportuara të dhunës në shkolla.
- Hetimin e incidenteve dhe ndjekjen e procedurave ligjore.

Bashkëpunimin me shkollat, DKA-të dhe QPS-të për parandalimin dhe trajtimin e rasteve.

- Zbatimin e programeve parandaluese dhe edukative për nxënësit (p.sh. përmes zyrtarëve të komunitetit dhe njësisë për mbrojtjen e të miturve).

Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA)

DKA-të janë institucione ekzekutive në nivel lokal që zbatojnë politikat arsimore të MASHTI-t dhe mbikëqyrin funksionimin e shkollave në komunë. Roli i tyre përfshin:

- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave të mbrojtjes së fëmijës në shkolla.
- Inicimin e aktiviteteve vetdijësuese dhe edukative për sigurinë e fëmijëve.
- Zbatimin e masave parandaluese për parandalimin e dhunës në shkolla.
- Koordinimin me Policinë dhe Qendrat për Punë Sociale për rastet e dhunës apo sjelljeve të rrezikshme.
- Përfshirjen e Këshillit të Nxënësve, Këshillit të Prindërve, dhe Zyrtarit për të Drejtat e Fëmijës në adresimin e çështjeve të sigurisë.

Shkollat (Institucionet Arsimore)

Shkollat janë vija e parë e zbatimit të politikave të sigurisë dhe kanë rol thelbësor në parandalimin e dhunës dhe krijimin e një mjedisi të sigurt për nxënësit. Ato janë përgjegjëse për:

- Zbatimin e politikave komunale dhe kombëtare të sigurisë.
- Raportimin e incidenteve në sistemin SMIA (Sistemi për Menaxhimin e Informacionit në Arsim)⁴⁹.
- Njoftimin e menjëhershëm të DKA-së, Policisë dhe QPS-së në rastet e dhunës.
- Përfshirjen e Këshillave të Nxënësve dhe të Prindërve në identifikimin e problemeve të sigurisë.
- Ofrimin e mbështetjes psikologjike dhe pedagogjike për nxënësit.

Qendrat për Punë Sociale (QPS)

QPS-të janë institucione komunale nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe ndërhyrje mbrojtëse për fëmijët. Roli i tyre lidhet ngushtë me rastet e dhunës në shkolla, duke përfshirë:

- Ndërhyrjen në rastet e dhunës, neglizhencës apo abuzimit ndaj fëmijëve.
- Vlerësimin e rrezikut dhe sigurimin e mbrojtjes së menjëhershme për fëmijën.
- Koordinimin me Policinë dhe DKA-në për trajtimin e rasteve.
- Monitorimin e cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara për fëmijët në komunitet.

Mekanizmat tjerë Mbështetës dhe Koordinues

Në nivel komunal dhe shkollor ekzistojnë mekanizma shtesë që kontribuojnë në sigurimin e një mjedisi të mbrojtur:

- Komisioni Disiplinor i shkollës
- Zyrtari për të Drejtat e Fëmijës koordinon çështjet që lidhen me mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijëve në komunë dhe funksionon në kuadër të DKA-së⁵⁰.
- Këshilli i Prindërve bashkëpunon me shkollat dhe DKA-në për çështjet që ndikojnë në sigurinë e nxënësve.
- Këshilli i Nxënësve shpreh shqetësimet e nxënësve dhe merr pjesë në nisma parandaluese.

Metodologjia e auditimit dhe fushëveprimi i auditimit

Për të mbledhur dëshmi gjithëpërfshirëse dhe për të vlerësuar mekanizmat dhe veprimet e institucioneve përgjegjëse për sigurinë në shkollat publike metodologjia e auditimit do të përfshijë analizimin e dokumenteve dhe ekzaminimin e hapave të listuar si në vijim:

- I. Analizë e publikimeve dhe dokumenteve të organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore që kanë aktivitet mbrojtjen e fëmijëve dhe trajtimin e rasteve të dhunës dhe sigurisë në shkolla.
- II. Analizë e dokumenteve në kuadër të institucioneve dhe akterëve përkatës duke u bazuar në rolin dhe përgjegjësinë e secilit prej tyre dhe llojin e dokumenteve që i takon secilit sikurse janë:

MASHTI- Politikat, strategjitë, raportet vjetore, udhëzuesit administrativ etj.

DKA- Raportet vjetore, përmbushja e planeve të veprimit dhe analizimi i masave dhe veprimeve të ndërmarra për parandalim, dhe trajtim të rasteve të dhunës. Rregulloren e punës së DKA-së, formën se si mbikëqyrin dhe si bashkëpunojnë me shkollat, kodi i etikës për personelin e shkollave, trajnimet e mësimdhënësve etj.

⁴⁹ SMIA është një softuer që përdoret vetëm nga insitucionet e arsimit duke filluar nga Ministria deri tek shkollat, por si softuer nuk lidhet me asnjë nga institucionet tjera

⁵⁰ Rregullore qrk- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, neni 4, pika 1.2 fq 10

Policia- Programet parandaluese, strategjinë për parandalim dhe reagim në rastet e incidenteve, raportet vjetore dhe mënyrën e reagimit dhe trajtimit të rasteve.

Shkollat- Analizimi i formës së regjistrimit, raportimit dhe trajtimit të incidenteve të dhunës, planin e sigurisë në shkolla, rregulloret e brendshme të shkollave, vlerësimin e brendshëm të shkollave, vlerësimin e mësimdhënësve, veprimet që ndërmerr këshilli i sigurisë në shkolla etj.

Inspektorati- aktivitetet inspektuese, vlerësimet e jashtme, raste të incidenteve apo ankesave të trajtuara, masat e ndërmarra disiplinore qoftë ndaj mësimdhënësve apo menaxhmentit të shkollave në rastet e shkeljeve.

Akterë tjerë të përfshirë direkt apo indirekt Raporte, informacione, statistika dhe të dhëna relevante. Analizimi i praktikave të shkollave private në Kosovë dhe mekanizmave që ata përdorin për të arritur sigurinë në shkolla. Kjo do të bëhet nga raportet që ata dorëzojnë në MASHTI dhe në inspektoratin e arsimit.

1. Analizimi dhe krahasimi i të dhënave dhe shifrave nga burime të ndryshme sikurse janë: Krahasimi i numrit të rasteve të raportuara në SMIA me të dhënat e Policisë. Gjithashtu do të analizohen edhe listat dhe të dhënat nga inspektorati lidhur me rastet e trajtuara nga vet inspektorati i arsimit, ku do të verifikohet se si nëse të njëjtat janë regjistruar në SMIA dhe janë trajtuar si duhet nga ana e shkollave.
2. Analiza e mostrave për tri komunat që janë pjesë e auditimit. Mostrat do të merren nga rastet e regjistruara në SMIA si dhe nga regjistrat që mbajnë DKA-të dhe shkollat për rastet e incidenteve. Numri i mostrave përcaktohet në proporcion me vëllimin e incidenteve.
3. Realizimi i intervistave me palët e përfshira në auditim sikurse janë: menaxhmenti i shkollave, personeli i shkollës (mësues, pedagogë dhe psikologë), zyrtarët e DKA-ve, zyrtarët e MASHTI-t, zyrtarë të inspektoratit dhe zyrtarë të Policisë.
4. Realizimi i pyetësorëve me nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe me nxënës të shkollave të mesme të larta me qëllim që të identifikohet saktë nëse shkollat raportojnë çdo herë rastet e incidenteve dhe nëse i trajtojnë ato. Pyetësorët do të realizohen në disa shkolla, duke përfshirë së paku dy shkolla në secilën komunë që është mostër e auditimit dhe duke përfshirë edhe shkolla të mesme të ulëta edhe shkolla të mesme të larta. Për realizimin e pyetësorëve do të merret aprovim paraprak nga DKA-të përkatëse. Pyetësorët nuk do të kërkojnë zbulimin e identitetit të nxënësve por vetëm: moshën, gjininë, klasën dhe numrin e ditarit.
5. Ekzaminime fizike të disa shkollave në terren me qëllim që të vlerësohet nëse shkollat përmbushin kushtet fizike të sigurisë sikurse janë: kamera, rrethojat, ndriçimi, kontrollimi i hyrje-daljeve.
6. Analizë krahasuese me praktikën e shteteve të rajonit dhe të BE-së për sistemet e trajtimit, raportimit dhe parandalimit të dhunës në shkolla.
7. Intervista dhe takime me këshillin e prindërve, këshillin e sigurisë në shkolla, organizata nga shoqëria civile që kanë fokus sigurinë në shkolla apo palët e tjera të interesit.

Fushëveprimi përfshin periudhën 2022-2025 me fokus në vlerësimin e mekanizmave ekzistues kundër dhunës në shkolla si dhe veprimeve të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për të garantuar sigurinë në shkolla. Subjekt i auditimit janë shkollat e mesme të ulëta publike dhe shkollat e mesme të larta publike. Fushëveprimi i këtij auditimi ka përfshirë institucionet në nivel qendror dhe lokal.

Në nivel qendror do të përfshijë institucionet si: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit (MASHTI), Inspektoratin e Arsimit.

Në nivel qendror gjithashtu mund të përfshijmë edhe Policinë e Kosovës, nëse nga mostrat e auditimit të incidenteve të dhunës brenda shkollave rezultojnë raste të referuara në Polici. Po ashtu nga Policia e Kosovës mund të marrim edhe të dhëna, programet që aplikojnë për parandalimin e dhunës dhe format e reagimit të dhunës brenda shkollave.

Në nivel qendror gjithashtu mund të përfshihet edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nëse nga mostrat e auditimit të incidenteve brenda shkollave rezultojnë raste të referuara në QPS.

Në nivel lokal do të përfshijë: Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), Shkollat që janë pjesë e mostrës së komunave përkatëse. Pjesë e mostrës së auditimit janë tri komuna. Në mënyrë që komunat e përzgjedhura të jenë sa më reprezentative dhe gjithëpërfshirëse janë kombinuar elementet si:

- numri i nxënësve në nivel të komunës,
- numri i shkollave në nivel të komunës,
- numri i rasteve të raportuara në SMIA si dhe
- numri i rasteve të raportuara nga Policia e Kosovës.

Komuna e Prishtinës pasi që është e para për numër të nxënësve, e dyta për numër të shkollave, si dhe e para për numrin e rasteve të raportuara në SMIA dhe në Polici.

Komuna e Ferizaj është përzgjedhur si komunë e mesme pasi që është e treta për numër të nxënësve, e katërta për numër të shkollave, e treta për numrin e rasteve të raportuara në SMIA dhe e gjashta për numrin e rasteve të raportuara në polici. Pra kjo komunë raporton raste në SMIA më shumë krahasuar me komunat tjera të nivelit të ngjashëm.

Komuna e Gjakovës është përzgjedhur për arsyen kryesore që është ndër komunat e mesme që bazuar në raportet e policisë është komuna e katërt për nga numri i rasteve të incidenteve të dhunës. Kjo komunë është e gjashta për numrin e nxënësve dhe numrin e shkollave në nivel të Kosovës.

Në kuadër të MASHTI do të fokusohemi kryesisht në Departamentin e Arsimit Parauniversitar ku do të analizohen dhe vlerësohen vendosja e politikave dhe strategjive si dhe veprimet e ndërmarra nga ky departament lidhur me sigurinë në shkolla. Gjithashtu mund të përfshihet edhe Departamenti për Zhvillimin e Standardeve dhe Normativave për Hapësirat Arsimore i cili ka për detyrë që në bashkëpunimin me Drejtoritë Komunale të krijojë hapësira të përshtatshme fizike në shkolla.

Në kuadër të **Inspektoratit të Arsimit** si njësi e veçantë në kuadër të MASHTI do fokusohemi tek roli dhe përgjegjësia e tyre lidhur me mbikëqyrjen, kontrollimin dhe monitorimin e institucioneve arsimore dhe ndikimin që inspektorati ka sa i përket sigurisë në shkolla.

Në kuadër të **Drejtorive Komunale të Arsimit** do të fokusohemi në tri komunat që janë mostër e auditimit, ku do të analizohen të gjitha aktivitetet, masat, politikat, veprimet dhe strategjitë që kanë ndërmarrë këto komuna me qëllim që të ulin numrin e incidenteve të dhunës në shkolla dhe të rrisin sigurinë dhe përmirësojnë ambientin në shkolla.

Në kuadër të **Institucioneve Arsimore** do të përfshihen disa shkolla nga tri komunat që janë subjekt i auditimit duke përfshirë shkolla nga niveli i arsimit të mesëm i ulët pra nga klasa 6 deri në klasën e 9 dhe shkollat e arsimit të nivelit të mesëm të lartë pra nga klasa 10 deri në klasën e 12. Këtu janë analizuar ndër tjera forma se si menaxhmenti i shkollave ka bërë identifikimin, regjistrimin dhe trajtimin e incidenteve të dhunës në shkolla.

Shtojca 2. Numri i rasteve sipas raporteve të Policisë dhe SMIA

Tabela 18- Numri i rasteve të raportuara nga gjitha shkollat në nivel vendi në SMIA vitet 2022-2025

Raportimi nga gjitha shkollat në nivel të Kosovës 2022-2025					
Rajoni	Komuna	2022/23	2023/24	2024/25	Totali për tri vite
Prishtinë	Prishtinës	14	18	12	44
	Fushë Kosovë	1	1	1	3
Prizren	Prizren	1	0	0	1
Pejë	Pejë	0	0	1	1
	Klinë	0	0	2	2
Gjilan	Gjilan	1	0	0	1
	Viti	1	0	1	2
Mitrovicë	Mitrovicë Jugore	1	1	3	5
	Vushtrri	8	0	1	9
Ferizaj	Ferizaj	0	0	17	17
	Shtime	3	1	1	5
Gjakovë	Gjakovë	15	6	6	27
	Malishevë	0	0	0	0
Gjithsej për vit		45	27	45	117

Pra, sikurse shihet nga tabela e paraqitur më sipër ku janë prezantuar të dhënat e rasteve të dhunës të raportuara në SMIA nga të gjitha komunat e Kosovës, shihet se numri i raportimit është i ulët. Aktualisht të vetmet të dhëna për dhunën në shkolla në nivel kombëtar janë të dhënat nga Policia e Kosovës të paraqitura në vijim.

Tabela 19- Numri i rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës

Numri i rasteve sipas raporteve nga Policia e Kosovës sipas viteve 2022-2025				
Rajoni	2022	2023	2024	2025
Prishtinë	202	187	192	189
Prizren	52	57	52	111
Pejë	56	61	104	94
Gjilan	88	85	69	79
Mitrovicë	43	49	40	26
Ferizaj	42	55	58	69
Gjakovë	96	67	62	63
Mitrovicë Veri	16	3	0	0
Gjithsej për vit	595	564	577	631

Në tabelën në vijim, të dhënat janë analizuar edhe nga palët e përfshira në konflikt dhe rezulton se dominojnë konfliktet nxënës-nxënës, pra janë konflikte të shkollave dhe nxënësve.

Tabela 20- Numri i incidenteve sipas palëve të përfshira në incident, në raportet e policisë në nivel vendi për periudhën 2022-2025

Viti	Nxënës- Nxënës	Nxënës - Arsimtar	Gjithsej	Viti	Nxënës- Nxënës	Nxënës - Arsimtar	Gjithsej
Prishtinë				Pejë			
2022	124	19	143	2022	39	3	42
2023	117	9	126	2023	32	3	35
2024	131	9	140	2024	73	2	75
2025	119	7	126	2025	62	1	63
Ferizaj				Gjilan			
2022	12	6	18	2022	43	3	46
2023	25	2	27	2023	54	7	61
2024	15	9	24	2024	45	8	53
2025	36	5	41	2025	51	4	55
Gjakovë				Mitrovicë Jug			
2022	41	12	53	2022	26	6	32
2023	37	6	43	2023	23	2	25
2024	22	7	29	2024	31	0	31
2025	30	9	39	2025	21	1	22
Prizren				Mitrovicë Veri			
2022	28	4	32	2022	1	0	1
2023	29	6	35	2023	3	0	3
2024	35	4	39	2024	0	0	0
2025	57	7	64	2025	0	0	0
Numri total i rasteve në nivel nacional në raportet e policisë 2022-2025							1523

Pra sikurse shihet në tabelën më sipër janë gjithsej 1,523 raste në nivel vendi të raportuara në PK, të cilat kanë ndodhur në periudhën 2022-2025.

Tabela 21- Aktivitetet e stacioneve policore në shkolla viti shkollor 2024-2025

Komuna	Stacioni policor	Aktivitetet për vitin shkollor 2024/2025
Prishtinë	Stacioni policor Jugu	Takime me shkollat, 596 Persona të ndaluar, 724 Kontrolle, 541 Intervenime 147
	Stacioni policor Veriu	Patrollime rreth shkollave, 745 Takime me DKA, 3
Gjakovë	Stacioni policor	Takime me drejtorë të shkollave, 147

Ora e kujdestarisë

Ora e kujdestarisë paraqet një mekanizëm të rëndësishëm për parandalimin e dukurive negative dhe trajtimin e konflikteve mes nxënësve, pasi kujdestari i klasës është personi që njihet më së miri me nxënësit dhe gjendjen e tyre sociale dhe familjare. Përmes kësaj ore mundësohet identifikimi më i hershëm i problemeve dhe trajtimi më efektiv i konflikteve. Megjithatë, për shkak se ora e kujdestarisë nuk njihet si normë e veçantë mësimore, shumica e shkollave nuk organizojnë orë të rregullta kujdestarie gjatë javës. Nga ajo që kemi identifikuar shumica e shkollave e praktikojnë këtë orë kujdestarie vetëm në fillim të gjysmë-vjetoreve, në fund të tyre dhe kur ka situata më të jashtëzakonshme.

Ndërsa kemi arritur të identifikojmë dy shkolla në Prishtinë që kishin gjetur forma alternative për mbajtjen e orës së kujdestarisë. Shkolla Gjergj Fishta, ku me vendim të drejtoreshës në vitin 2022, ditëve të mërkura ishin shkurtuar orët mësimore për të mundësuar mbajtjen e orës së kujdestarisë. Ndërsa në shkollën Nazim Gafurri, me vendim të KDSH-së në vitin 2022, ishte vendosur që çdo të hënë, pas pushimit të gjatë, të mbahej ora e kujdestarisë për 40 minuta, duke u shtyrë fillimi i mësimin për 40 minuta. Megjithatë, gjatë auditimit nuk është arritur të konfirmohet nëse këto praktika vazhdojnë të zbatohen ende.

Sidoqoftë kjo çështje nuk është rregulluar ende në nivel nacional. Nga MASHTI kemi pranuar evidenca ku në mars të vitit 2025 ishte dërguar në Ministrinë e Financave "draft propozimi për grantin specifik për arsimin parauniversitar për komuna për vitin 2026". Në kuadër të këtij propozimi ishte kërkuar që të lejohet ora e kujdestarisë sepse ndikon në parandalimin e dukurive negative në shkolla si dhe ishin dhënë arsyetimet tjera pse duhet të aprovohet. Propozimi parashihte që me orën e kujdestarisë të mbulohen 8421 paralele në nivel vendi dhe kishte një kosto shtesë për buxhetin e Kosovës në vlerë prej 2 milion euro.

Shtojca 3. Praktikrat e shkollave private të vizituara

Me qëllim të identifikimit të praktikave të mira kemi vizituar edhe dy shkolla private ku kemi identifikuar metodat e punës dhe praktikrat që këto shkolla aplikojnë lidhur me parandalimin dhe trajtimin e incidenteve të dhunës në shkolla. Në vijim janë të paraqitura disa nga këto praktika.

Shkolla Private I- Praktikrat e identifikuara në një shkollë private me mbi 200 nxënës

Trajtimi i incidenteve realizohet nga Ekipi për Sigurinë e Fëmijëve. Rastet raportohen në sistemin elektronik të shkollës dhe tek lideri i ekipit.

Masat disiplinore janë të kategorizuara në tri nivele sipas peshës së veprës dhe sjelljes. Ato përfshijnë konfiskimin e pajisjeve elektronike, detyra reflektuese me shkrim, takime me prindërit dhe drejtuesit e shkollës, uljen e notës së sjelljes, përjashtimin brenda shkollës dhe përjashtimin e përkohshëm nga shkolla.

Vizitat nga palët e treta lejohen vetëm me takim të caktuar paraprakisht.

Trajnimet e mësimdhënësve organizohen një herë në muaj në kuadër të ditës së trajnimeve.

Siguria fizike e shkollës sigurohet përmes rrethojës dhe dyerve të mbyllura gjatë procesit mësimor, si dhe përmes sistemit të alarmit të tymit, i cili sinjalizon edhe konsumimin e duhanit apo cigareve elektronike në tualete.

Përgatitja për raste emergjente përfshin simulime të rregullta të evakuimit për fatkeqësi natyrore, përfshirë evakuimin në rast zjarri.

Shërbimi psiko-social ofrohet nga një psikolog i angazhuar në shkollë.

Shkolla Private I- Praktikrat e identifikuarat në një shkollë private me mbi 1,000 nxënës

Aktivitetet vetëdijësuese kundër dhunës dhe bullizmit përfshijnë video sensibilizuese, materiale multimediale, lojëra me role dhe skenarë ilustrues. Nëpërmjet fletëve të punës, nxënësit identifikojnë shqetësimet e tyre dhe mësojnë të dallojnë viktimën dhe ushtruesin e dhunës.

Trajtimi i rasteve të dhunës realizohet nga komisioni disiplinor përmes formularëve standardë që dokumentojnë rastin, nxënësit e përfshirë dhe masat e ndërmarra.

Raportimi i incidenteve bëhet përmes një formulari të standardizuar, i cili plotësohet brenda 24 orëve nga ngjarja dhe përcakton qartë përgjegjësit për trajtimin e rastit.

Masat disiplinore përfshijnë uljen e notës së sjelljes, angazhime në mirëmbajtjen e hapësirave të shkollës, aktivitete vetëdijësuese dhe qëndrim të zgjatur në shkollë.

Rregullorja e shkollës zbatohet edhe jashtë ambienteve të shkollës, gjatë aktiviteteve, ekskursioneve dhe transportit shkollor.

Dalja e nxënësve nga shkolla realizohet vetëm me miratimin e prindit, mësimitdhënësit dhe administratës.

Kujdestaria e ditës mbulon tërë orarin mësimor dhe përfshin mbikëqyrjen e nxënësve, kontrollin e hapësirave të shkollës dhe raportimin e incidenteve.

Masat e sigurisë fizike përfshijnë rrethimin e objektit, roje sigurie, kamera, sistem alarmi dhe pajisje skanimi në hyrje.

Pyetësorët me nxënësit përdoren për të identifikuar rastet e ngacmimit dhe bullizmit.

Shërbimi psiko-social ofrohet nga një psikolog i angazhuar në shkollë.

Kjo shkollë mbledh telefonat e nxënësve në fillim të orarit dhe i mban në një dollap në kuti të veçanta, të paraqitura në foton më poshtë.

Foto 8- Dorëzimi dhe ruajtja nëpër kuti i telefonave të nxënësve gjatë qëndrimit në shkollë- Shkollë Private e vizituar (1000 nxënës)



Shtojca 4. Letër konfirmimet dhe komentet e entiteteve



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /Ministry of Internal Affairs
Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate







06	42	1235	1
----	----	------	---

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit Vendi dhe data: Prishtinë 06/07/2026

I/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë” (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kolonel Gazmend Hoxha
Drejtues i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës





Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. Luan Haradinaj pm. 10000 Prishtinë – Kosovë,
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës,



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANORSHKËZUAR PËRSHIRJE: 15-07-2026			
1" JAVOVED-DUJUTTER			
Org. Orig. Org. Jedn. Org. Udar.	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Dr. Prot. Prot. No.	Nr. Faqeve Dr. Stranica No. Pages
06	47	1325	1

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës "Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë", dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit
Data: 03.07.2026

Vendi Gjakovë dhe

I/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit "Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë" (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Ardian Gjini

për 
Kryetari i Komunesë Gjakovës





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



LETËR E KONFIRMIMIT

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
LLETËR E KONFIRMIMIT			
Kryetari/Pr. J. A. A. Opšt. Uroš.	Opšt. Uroš.	Opšt. Uroš.	Opšt. Uroš.
06	47	1447	1

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nr. 295
Vendi dhe data: 07.07.2016

I/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë” (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari/Kryeshefi/Exekutiv





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit dhe Shkencës/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/Ministry of Education and Science

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e performancës me temën: **“Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë”**, për periudhën 2022-2025
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet ndërsa komentet dhe dëshmitë i gjeni të bashkangjitur
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Hajrullah Ceku

Ministër në detyrë i Arsimit dhe Shkencës

Data: 16/7/2026

Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Auditimi i kryer: "Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë"

Dokumenti: Komentet nga institucioni i audituar në draft raportin e auditimit

Gjetjet	Pajtohem po/ jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne raste te mospajtimi	Pikëpamja e ZKA-së
Gjetja 3.1.1	Jo	Rrjeti për menaxhimin e rasteve të dhunës nuk ka bashkëpunuar në formë efektive (paragrafi referues): "MASH-i nuk ka hartuar formularët standard të referimit, edhe pse ata janë paraparë me Rregulloren për Protokollin". MASH e konfirmon se: formularët janë hartuar me kohë si shtojcë e rregullores dhe u janë dhënë me CD bashkë me protokollin, të gjitha institucioneve edukative-arsimore (dhe të bashkëlidhur janë dërguar formularët, njësoj siç ishin për aplikim në version fizik). Me krijimin e kushteve me infrastrukturën teknologjike, format e raportimit fizik, janë kthyer në version online në modul SMIA, dhe për këtë proces janë informuar shkollat dhe DKA në seancat e rregullta të informimit dhe trajnimit për mënyrën e raportimit në SMIA. Formatin e standardizuar të raportimit e ka çdo shkollë. Po ashtu, atëherë u është ofruar edhe video-tutori për mënyrën e raportimit. Shënim: Protokoli Nr 21/2013 nuk sjellë detyrime shtesë për institucionet, por i liston obligimet institucionale (rolin dhe përgjegjësitë) që derivojnë nga ligjet sektoriale ekzistuese.	Gjetja qëndron. ZKA ka shqyrtuar komentin e MASHTI-t, mirëpo sqarimet e dhëna nuk e kundërshtojnë gjetjen. Në raportin e auditimit është trajtuar mungesa e formularëve standardë të referimit të rasteve nga shkollat te institucionet tjera, si Policia e Kosovës dhe Qendrat për Punë Sociale. Ndërsa komenti i MASHTI-t kryesisht i referohet formularëve të evidentimit/raportimit të rasteve, përfshirë regjistrat fizikë dhe raportimin në SMIA. Referimi dhe raportimi janë procese të ndryshme. Referimi nënkupton përcjelljen e rastit për trajtim te institucioni përgjegjës, ndërsa raportimi nënkupton evidentimin apo regjistrimin e rastit në formularë fizikë ose në SMIA. Prandaj, në mungesë të dëshmive që tregojnë ekzistencën dhe përdorimin e formularëve të veçantë standardë për referim, gjetja mbetet e pandryshuar.
Gjetja 3.1.4	Pjesërisht	Të dhënat e raportuara nga shkollat nuk janë të sakta dhe të besueshme, përkatësisht referenca për periudhën e raportimit dy herë në vit: "Të dhënat e raportuara në SMIA janë dukshëm më të ulëta se rastet e evidentuara në raportet e Policisë së Kosovës dhe në evidencat fizike të shkollave". Ky afat i raportimit ka qenë i paraparë për raportimin e rregullt në version fizik (dy herë në vit), por kur u bë moduli online, është lënë aktiv për tu raportuar rastet që ndodhin "ad hoc" në kohën kur ndodhin. Sistemin e ka krijuar MASH, ashtu që raportimet dhe evidencat, tu shërbejnë shkollave dhe komunave për orientimin e politikave (planet zhvillimore të shkollave dhe komunave), bazuar në dëshmi. Dallimi i raportimit të shkollave në SMIA me evidencat e tyre në shkollë vjen si pasojë e	Gjetja qëndron. ZKA ka marrë parasysh sqarimin e MASHTI-t lidhur me raportimin "ad hoc" në SMIA dhe dallimin mes të dhënave të SMIA-së, evidencave të shkollave dhe të dhënave të Policisë. Megjithatë, të dhënat e auditimit tregojnë se raportimi në SMIA nuk është zbatuar në mënyrë të plotë dhe të njëtrajtshme. Referenca që i referohet MASHTI "dy herë në vit" është kriteri i auditimit i referencuar sipas rregullores së protokollit 21/2013 dhe gjendet në gjetjen me titull Të dhënat e raportuara nga shkollat nuk janë të sakta dhe të besueshme . Përkundër zhvillimit të sistemit online, në rregullore nuk kërkohet që raportimi të bëhet në këtë sistem por kërkohet të bëhet me regjistra

		mosraportimit të rregullt nga shkollat edhe për faktin që sistemi i Policisë për sigurinë në bashkësi, evidencën për lokacionet në komunitet, i ka të emërtuara si “incidente në dhe përreth shkollave”, ku hyjnë edhe rastet në lagje dhe komunitet (jo vetëm rastet e shkollave). Bazuar në këtë të gjitha shifrat që i gjeneron sistemi policor nuk janë vetëm raste të shkollave.	fizik dy herë në vit gjë që shpjegohet në gjetjen e auditimit. Gjatë periudhës 2022–2025, në nivel vendi në SMIA janë raportuar vetëm 117 raste të dhunës, ndërsa vetëm nga mostra prej 30 shkollave të audituara janë identifikuar 535 raste të evidentuara në dokumentacionin fizik të shkollave. Kjo dëshmon se sistemi SMIA nuk paraqet gjendjen reale të rasteve të dhunës në shkolla. Sa i përket të dhënave të Policisë, ZKA ka marrë parasysh se një pjesë e rasteve mund të jenë evidentuar si incidente “në dhe përreth shkollave”. Megjithatë, analiza e raportit tregon se shumica e rasteve lidhen me konflikte nxënës–nxënës apo nxënës–mësimdhënës, si dhe se numri i incidenteve bie ndjeshëm gjatë muajve korrik dhe gusht, kur shkollat janë në pushim. Këto elemente mbështesin vlerësimin se një pjesë e konsiderueshme e rasteve lidhen drejtpërdrejt me mjedisin shkollor.
Gjetja 3.2.3	Jo	Për mungesën e Strategjisë kombëtare për sigurinë në shkolla MASH e ka hartuar Strategjinë për sigurinë në shkolla por kjo nuk ka kaluar për shkak të kufizimit të numrit të strategjive. Objektiva strategjike për shkollat e sigurta dhe të shëndetshme u përvetësuan në vazhdimësi në strategjitë e arsimit. MASH, përveç në nivel strategjik, sigurinë në shkolla e ka integruar dhe trajtohet përmes kurrikulave, trajnimeve, aspekteve infrastrukturore dhe qasjes ndërinstitucionale të raportimit dhe referimit. Nga kjo perspektivë, Strategjia për sigurimin e cilësisë e referuar në Raport, nuk lidhet drejtpërdrejtë me sigurinë, po përmes arsimit cilësor e promovon sigurinë dhe i edukon brezat e rinj për paqen, duke krijuar vlerat e qëndrimit pozitive të demokracisë: respektin, tolerancën, gjithëpërfshirjen, barazinë, shmangien nga dhuna e abuzimi etj. MASH e mbështetë rekomandimin për hartimin e saj, ndonëse legjislacioni aktual përfshirë edhe Ligjin për mbrojtjen e fëmijës me aktet nënligjore, janë më të fuqishme dhe më obliguese sesa çdo dokument strategjik.	Gjetja qëndron, me sqarimin se çështja kryesore është mungesa e një strategjie të aprovuar dhe funksionale. ZKA ka marrë parasysh sqarimin e MASHTI-t se një draft-strategji për sigurinë në shkolla ishte hartuar, por nuk ishte miratuar. Ky sqarim nuk e kundërshton gjetjen e auditimit, pasi raporti trajton mungesën e një strategjie të aprovuar, të zbatueshme dhe të monitorueshme për sigurinë në shkolla. Fakti që siguria është trajtuar në kuadër të kurrikulave, trajnimeve, manualeve apo dokumenteve tjera sektoriale nuk e zëvendëson nevojën për një kornizë të qartë strategjike që përcakton objektiva, masa, përgjegjësi, afate, mekanizma monitorimi dhe tregues për vlerësimin e rezultateve në fushën e sigurisë në shkolla. Prandaj, gjetja mbetet e pandryshuar.
Gjetja 3.2.3	Jo	“Rregullorja për Protokollin nuk përbën obligim për drejtorët e shkollave për raportimin e rasteve të dhunës në sistemin SMIA” Neni 2 i protokollit, paragrafi 1.17 e përcakton se: “Regjistri i rasteve në institucionet e arsimit parauniversitar nënkupton bazën e të dhënave në të cilën regjistrohen rastet e raportuara të	Gjetja qëndron. ZKA ka shqyrtuar nenet e cituara nga MASHTI lidhur me regjistrimin, ruajtjen dhe analizimin e të dhënave për rastet e dhunës. Këto dispozita mbështesin obligimin për evidentimin dhe mbajtjen e regjistrit të rasteve, mirëpo ato nuk përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të

		dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar i shënuar si Shtojca I e këtij Protokollit” (shtojca është dërguar bashkëlidhur Auditorëve). Detyrimi ligjor për raportim trajtohet në nenin 19, 20 dhe në nenin 25 të Protokollit: Sigurimi, ruajtja dhe analizimi i të dhënave në institucionet e arsimit parauniversitar, paragrafët 1 dhe 2 të nenit 25: 1. Drejtori i institucionit të arsimit para-universitar është obliguar të sigurojë, ruajë dhe analizojë të dhënat mbi dhunën e paraqitur në institucionin që ai/ajo drejton, në mënyrën më të mirë të mundshme. 2. Regjistri i rasteve të dhunës në institucionet e arsimit para-universitar mbahet sipas Shtojcës 1, të këtij Protokollit dhe është konfidencial. Kur drejtori siguron, ruan dhe analizon të dhëna apo mban regjistrin e rasteve sipas shtojcës 1, nënkupton se ai duhet t’i regjistrojë të dhënat te Regjistri i rasteve, dhe regjistri është i integruar në SMIA në mënyrë digjitale, për përdorim më të lehtë. Për çka përshtatshmërisht janë informuar drejtorët e shkollave dhe DKA-të. Gjithashtu me pikën 6 te pjesa 5 e Udhëzuesit thuhet: “6. Drejtori i IAP regjistron dhe azhurnon rastin në SMIA/MASHT, sipas aneksit 4 (Manuali për përdorimin e modulit “regjistri i rasteve”). Sipas informatave nga diskutimet në terren, tryezat e vazhdueshme, arsyet pse nuk raportohen apo nuk trajtohen si duhet rastet lidhen me nivelin e ndërgjegjësimit institucional, llogaridhënies, neglizhimin, frikën e shkeljes së privatësisë, mungesën e mbrojtjes për raportuesin, stigmatizimin, mos trajtimin efikas nga instancat tjera.	drejtpërdrejtë obligimin për raportimin e rasteve në sistemin SMIA. Rregullorja për Protokollin është aprovuar në vitin 2013, ndërsa moduli i raportimit në SMIA është zhvilluar më vonë. Për këtë arsye, rregullorja nuk është përditësuar për të harmonizuar raportimin fizik me raportimin elektronik në SMIA. Udhëzuesi i vitit 2015 e përshkruan përdorimin e SMIA-së, por nuk e zëvendëson nevojën për një detyrim të qartë normativ dhe procedurë të standardizuar për raportimin elektronik nga shkollat. Fakti që shkollat kanë zhvilluar praktika të ndryshme dhe se raportimi në SMIA ka mbetur shumë i ulët tregon se obligimi dhe procesi i raportimit nuk kanë qenë mjaftueshëm të qarta, të monitoruara dhe të zbatuara në mënyrë efektive.
Gjetja 3.2.3	Pjesërisht	“MASHTI nuk ka realizuar ndonjë analizë të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirëse lidhur me situatën e sigurisë në shkolla” MASH ndër vite ka bashkëpunuar me UNICEF, institucionin Pedagogjik me PK, OSBE-në për hulumtimet e realizuara që tregojnë për gjendjen ekzistuese dhe janë të njëjtë: familjarë, socialë, ekonomikë, tranzicioni i gjatë, prania e substancave narkotike, prania e lokaleve afër shkollave, elementet e delikuencës, pamjaftueshmëria e mbikëqyrjes prindërore, evoluimi i teknologjisë dhe abuzimet e teknologjisë etj.	Gjetja qëndron. ZKA ka marrë parasysh aktivitetet dhe bashkëpunimet e MASHTI-t me partnerë të ndryshëm, përfshirë hulumtime, manuale, materiale didaktike dhe aktivitete vetëdijësuese. Këto aktivitete janë reflektuar në raportin e auditimit aty ku janë mbështetur me dëshmi. Megjithatë, komenti nuk dëshmon se MASHTI ka realizuar një analizë të rregullt, të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirëse mbi sigurinë në shkolla, të bazuar në të dhëna të konsoliduara nga SMIA, DKA-të, shkollat, Policia, QPS-të dhe

		MASH i ka përqendruar veprimet sipas të gjeturave nga këto hulumtime. Përveç ligjeve dhe rregulloreve, janë zhvilluar manuale didaktike për ta mbështetur komunitetin e shkollave me trajtimin e temave të ndjeshme (të dhunës, trafikimit, mbrojtjes në internet, parandalimit të dukurive negative, edukimit për paqe etj) si dhe përmes aktiviteteve kurrikulare dhe ekstrakurrikulare me ndërveprim me shërbimet tjera. Po, gjithsesi ka nevojë për analiza të mëtejme duke përcjellë situatën në vazhdimësi.	Inspektorati i Arsimit. Për më tepër, vetë komenti i MASHTI-t pranon se ka nevojë për analiza të mëtejme dhe përcjellje të vazhdueshme të situatës. Prandaj, gjetja mbetet e pandryshuar.
Gjetja 3.2.3	Pjesërisht	“MASHTI nuk ka monitoruar zbatimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve që ka ndikuar që shkollat të aplikojnë praktika të ndryshme dhe jo të standardizuara. Sipas Ministrisë me këtë proces janë angazhuar OJQ-të në kuadër të marrëveshjeve bashkëpunuese sepse Ministria nuk ka resurse për të monitoruar zbatimin e saj”. Me aprovimin e Politikës për mbrojtjen e fëmijës të MASH-it, janë realizuar seancat informuese nëpër komuna, është zhvilluar dhe akredituar programi i trajnimit dhe kanë filluar trajnimet për pikat kontaktit të shkollave. Për programin e trajnimit është akredituar programi i një OJQ-je e specializuar për mbrojtjen e fëmijës, po nuk i është dhënë funksioni monitorues. Monitorimi dhe sigurimi i zbatimi të politikës i takon DKA-e dhe Inspektoratit të Arsimit, i cili do të merret në vazhdimësi.	Gjetja qëndron. ZKA ka marrë parasysh sqarimin e MASHTI-t se pas aprovimit të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës janë realizuar seanca informuese, është zhvilluar program trajnimi dhe kanë filluar trajnimet për pikat kontaktuese në shkolla. Megjithatë, këto aktivitete nuk dëshmojnë se është realizuar monitorim i rregullt dhe i dokumentuar i zbatimit të politikës në shkolla. Për më tepër, MASHTI në komentin e tij thekson se monitorimi i zbatimit të politikës i takon DKA-ve dhe Inspektoratit të Arsimit. Duke qenë se Inspektorati i Arsimit funksionon në kuadër të MASHTI-t, ky sqarim konfirmon përgjegjësinë institucionale për monitorim. Prandaj, komenti nuk e kundërshton gjetjen e auditimit.
Gjetja 3.2.4	Pajtohem pjesërisht	Inspektorati i Arsimit nuk bën mbikëqyrjen e sigurisë në shkolla Inspektorati në formatet e rregullta të inspektimeve dhe në bazë të kërkesave “ad hoc” e përcjell mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor, përfshirë edhe aspektet e sigurisë. Mungesa e inspektimeve tematike specifike vjen për shkakun e mungesës së kapaciteteve/resurseve njerëzore, gjë që do të adresohet.	Gjetja qëndron. ZKA ka marrë parasysh sqarimin e MASHTI-t se Inspektorati i Arsimit, në kuadër të inspektimeve të rregullta dhe në bazë të kërkesave ad hoc, mund të trajtojë edhe aspekte që lidhen me mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor. Megjithatë, komenti nuk ofron dëshmi se janë realizuar inspektime tematike apo mbikëqyrje të dedikuara për sigurinë në shkolla, zbatimin e protokollit, raportimin e rasteve në SMIA apo trajtimin e incidenteve të dhunës. Për më tepër, vetë komenti i MASHTI-t pranon se mungesa e inspektimeve tematike specifike lidhet me mungesën e kapaciteteve/resurseve njerëzore. Kjo mbështet gjetjen e auditimit se mbikëqyrja e sigurisë në shkolla nga Inspektorati nuk ka qenë efektive.



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës